



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 594 Akti

Nr. 639 Vendimi
Tiranë, më 31.3.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Francesco Ciardi, në datën 28.3.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Olger Eminaj**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Olger Eminaj me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.6.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
2. Trupi gjykues, i shortuar për të shqyrtuar çështjen, përbëhet nga komisionerët Suela Zhegu me cilësinë e relatores, Alma Faskaj dhe Etleda Çiftja. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 21.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionere Alma Faskaj. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Francesco Ciardi.
3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:
 - *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për dhurimin e banesës;*
 - *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
 - *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
 - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

¹ Raporti i dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2018.

6. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport² të arsyetuar, ku fillimisht ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës* dhe më pas ka ndryshuar³ konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, duke konkluduar në *papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Olger Eminaj*.
7. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar⁴ mbi subjektin e rivlerësimit.
8. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 20.2.2023, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Olger Eminaj dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
10. Pranë Komisionit, në datën 1.3.2023, është depozituar një denoncim, ku ngriheshin pretendime lidhur me kriterin profesional. Trupi gjykues, pasi u njoh me të, vendosi të riçelë hetimin administrativ për subjektin Olger Eminaj, vetëm për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, për të kryer veprime hetimore shtesë. Në datën 20.3.2023 trupi gjykues vendosi përfundimin e hetimit administrativ shtesë dhe në datën 21.3.2022 subjekti u njoftua për rezultatet e hetimit shtesë.
11. Për një proces të rregullt ligjor, z. Olger Eminaj i janë garantuar të drejtat: (i) për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues; si dhe (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Subjektin iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen e hetimit dhe për të disponuar kopje të saj, u njoh me rezultatet paraprake të hetimit administrativ, si dhe rezultatet e hetimit shtesë.
12. Z. Olger Eminaj, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e tij në datat 3.3.2023 dhe 24.3.2023. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit, deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas

² Raporti i kontrollit të figurës i dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017.

³ Raporti nr. *** prot., datë 20.5.2021 i DSIK-së, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 11.6.2021, të KDZH-së.

⁴ Raporti i miratuar me vendimin nr. ***, datë 19.12.2022, të KLP-së.

shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

13. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 24.3.2023.
14. Seanca dëgjimore u zhvilluan në datën 28.3.2023, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.
15. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Subjekti i rivlerësimit Olger Eminaj ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Z. Olger Eminaj ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

17. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.
18. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.
19. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.
20. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.
21. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:
- provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
 - raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
 - deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
 - provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
 - raportin e kontrollit të figurës së dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
 - raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
 - deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
 - shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
23. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Olger Eminaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, u krye mbi bazën e tri kriterëve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

24. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, si dhe mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesi.
25. Ky hetim është përqendruar mbi të gjitha pasuritë e deklaruara nga z. Olger Eminaj në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, të dorëzuar në ILDKPKI në datën 28.1.2017, në zbatim të ligjit, ku subjekti ka deklaruar pasuritë:
- 26. Apartament në përdorim⁵ në Korçë**, kati i tretë i një banese private, me sip. 106 m², në pronësi të z. J.B (vjeçrit). Vlera e deklaruar 4.851.665 lekë, sipas rivlerësimit të kryer në vitin 2011. I dhuruar pa dokumente nga vjeçri, z. J.B.

⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dokumentet vijuese: (1) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 5.12.2001, me palë shitëse H.K dhe A.K dhe palë blerëse J.B, për blerjen e pasurisë së regjistruar në emër të shtetasit H.K, një shtëpi dykatëshe, ndodhur në Korçë, lagjja nr. **, rruga "N.V", me sip. ndërtimi 107.2 m² dhe sip. totale 115 m², së bashku me truallin, pasuria nr. ***, z. k. *** dhe pasurisë së regjistruar në emër të shtetasit A.K, pjesa "*" e shtëpisë së ndodhur në qytetin e Korçës, rruga "K.D" e përbërë kjo pjesë prej garazhit, me sipërfaqe ndërtimi 45 m² dhe sip. oborri 70 m², pra gjithsej 115 m², pasuria nr. ***, z. k. ***. Pala shitëse deklaroi se shtëpinë dykatëshe + truall, si dhe pjesën "*" të shtëpisë + truall e shesin kundrejt vlerës 4.000.000 lekë; (2) certifikatë pronësie nr. ***, z. k. ***, të pasurisë apartament, me sip. 107.2 m², në emër të shtetasit J.B, ndodhur në rrugën "K.D", Korçë. Data e lëshimit të certifikatës 29.7.2011; (3) certifikatë pronësie nr. ***, z. k. ***, të pasurisë apartament, me sip. 125.43 m², në emër të shtetasit J.B, ndodhur në rrugën "K.D", Korçë. Data e lëshimit të certifikatës 29.7.2011; (4) certifikatë pronësie nr. ***, z. k. ***, të pasurisë apartament, me sip. 106.63 m², në emër të shtetasit J.B, ndodhur në rrugën "K.D", Korçë. Data e lëshimit të certifikatës 29.7.2011. Kartela e pasurisë së paluajtshme e lëshuar në datën 7.12.2011; (5) harta treguese e pasurisë nr. ***, (6) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 27.9.2001, me palë shitëse A.B dhe J.B dhe palë blerëse shoqëria "Tirana Bank", për shitjen e pasurisë nr. ***-N*, të gjithë pjesën e njësisë me truallin përkatës, e cila ka një sip. 101 m², ndodhur në z. k. ***, lagjja "D.H", banesa nr. ** (kati i parë), Elbasan. Çmimi i shitjes 16.000.000 lekë, shumë e cila është paguar plotësisht nga pala shitëse. Dokumentacioni i njehsuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. *** rep., datë 27.1.2017.

Hetimi i Komisionit

27. Komisioni ka hetuar dhe verifikuar përmes sistemit multifunksional të ASHK-së⁶, nga i cili nuk ka rezultuar pasuri e paluajtshme e regjistruar në regjistrin elektronik të pasurive në emër të subjektit Olger Eminaj dhe bashkëshortes së tij. Ndërsa shtetasit J.B dhe A.B (prindërit e bashkëshortes) kanë të regjistruar në emër të tyre pasurinë e paluajtshme të llojit “truall” me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. **, fq. ***, e ndodhur në Korçë.
28. Nga dokumentacioni⁷ i administruar nga ASHK Drejtoria Vendore Korçë⁸ konfirmohet pasuria nr. *** me sipërfaqe truall 149.6 m² dhe ndërtesë 146.3 m² e regjistruar në emër të shtetasve J.B dhe A.B, e blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 5.12.2001. Gjithashtu, shtetasi J.B figuron vetëdeklarues me nr. *** prot., viti 2006, për shtesë pa leje, si dhe është pajisur me leje legalizimi nr. ***, datë 26.11.2020, “Për shtesë anësore dhe në lartësi me funksion të kombinuar në godinën ekzistuese 2 kate”, Korçë.
29. FSHU-ja⁹ ka informuar se shtetasit Olger dhe O.E nuk rezultojnë të jenë abonentë dhe të kenë kontratë të furnizimit me energji elektrike, ndërsa me gjeneralitetet J.B identifikohet një abonent me kontratën e furnizimit në instancën Korçë, ku sipas të dhënave në sistemin e faturimit identifikohet kontrata e lidhur në datën 16.8.2005, në adresën rruga “K.D”, nr. *, e cila përkon me adresën e pasurisë së deklaruar nga subjekti.

Analiza e fakteve

30. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar dhurimin (pa dokumente) nga vjehri i tij, z. J.B, të katit të tretë të një shtëpie private me sip. 106.63 m², të ndodhur në rrugën ”K.D”, Korçë, ku vlera e pronës sipas rivlerësimit të kryer në vitin 2011 është 4.851.665 lekë.
31. Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri për herë të parë në deklarinimin para fillimit të detyrës¹⁰ të vitit 2009, ku ka deklaruar: “*Shtëpi, kati i tretë i një shtëpie private 3-katëshe, me adresë L. **, rruga ‘K.D’ nr. *, Korçë, ndërtuar në vitin 2004, sipërfaqe 115 m². Hyrja është e dhuruar, nuk disponoj ende dokumente. Vlera e kësaj prone afërsisht 50.000 euro, me pjesë takuese 50%*”. Në përgjigje

⁶ Vërtetimet e lëshuara elektronikisht në datën 14.11.2022, për aplikimet nr. ***, nr. ***, nr. *** dhe nr. ***, datë 9.11.2022.

⁷ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 5.12.2001, me shitës H.K e A.K dhe blerës J.B; lista e apartamenteve në emër të shtetasit J. B; planimetri e pasurisë nr. ***, planimetri e pasurisë nr. ***, planimetri e papafingos e nënshkruar nga topograf J.S; harta treguese e regjistrimit të pasurisë nr. ***, plan rievimi i pasurisë nr. ***, shkresë nr. *** prot., datë 10.12.2020, e Drejtorisë Vendore ASHK Korçë “dërgim i faturave financiare”; shkresë nr. *** prot., datë 28.12.2020, e Drejtorisë Vendore ASHK Korçë; formulari i pagesës së parcelës ndërtimore datë 24.12.2020, në emër të shtetasit J.B; mandate bankare të “Credins Bank” datë 10.12.2020 dhe datë 13.1.2021; faturë e lëshuar nga Drejtoria e ALUIZNI-t datë 7.12.2020; leje legalizimi nr. ***, datë 26.11.2020, në emër të shtetasit J.B; genplani i pasurisë; pamje fotografike e printuar nga gjeoportali; planimetria e katit përdhe; planimetria e katit të parë; planimetria e papafingos; kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***, e lëshuar në datën 6.4.2021; kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***, e lëshuar në datën 6.4.2021; kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***, e lëshuar në datën 6.4.2021; kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***-ND, e lëshuar në datën 7.4.2021; kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***, e lëshuar në datën 6.4.2021; kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***, e lëshuar në datën 7.4.2021; kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***, e lëshuar në datën 7.4.2021; fragment i hartës kadastrale, e lëshuar në datën 7.4.2021; kërkesë nr. ***, datë 23.3.2021, për regjistrim të bashkimit të pasurive dhe lëshim certifikate pronësie; mandat bankar “Credins Bank” datë 25.3.2021; certifikatë pronësie nr. ***, e lëshuar në datën 29.7.2011, për pasurinë nr. ***, në emër të shtetasit J.B; certifikatë pronësie nr. ***, e lëshuar në datën 29.7.2011, për pasurinë nr. ***, në emër të shtetasit J.B; certifikatë pronësie nr. ***, e lëshuar në datën 29.7.2011, për pasurinë nr. ***, në emër të shtetasit J.B; certifikatë regjistrimi pronësie, e lëshuar elektronikisht në datën 2.3.2021, për pasurinë nr. ***-ND, në emër të shtetasit J.B, shoqëruar me kartelë pasurie dhe fragment i hartës kadastrale; certifikatë e përbërjes familjare të z. J.B; certifikatë familjare e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Korçë në datat 6.4.2021 dhe 8.4.2021 (për gjendjen familjare të vitit 5.12.2001).

⁸ Me shkresat: nr. *** prot., datë 22.12.2022; nr. *** prot., datë 24.11.2022; si dhe nr. *** prot., datë 19.12.2022.

⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 31.3.2021.

¹⁰ Periudhë kur subjekti ka qenë prokuror në stazh.

të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar se që nga momenti i marrjes së detyrës deri aktualisht ka jetuar në banesën e vjehrrit për të cilën nuk ka paguar qira.

32. Referuar çertifikatës martesore¹¹ të lëshuar në datën 17.1.2023 nga Zyra e Gjendjes Civile Kolonjë, evidentohet se subjekti ka lidhur martesë me shtetasen O.B (E) në datën 15.9.2008 dhe nuk ka pasur ndryshime në gjendjen civile dhe familjare.
33. Nga verifikimi i deklaramëve në vite, nga viti 2009 dhe në vijim, subjekti ka deklaruar të njëjtën adresë vendbanimi “Lagjja nr. **, rruga ‘K.D’, nr. *, Korçë”, e cila përkon me vendndodhjen e banesës së poseduar nga subjekti.

Komisioni hetoi mbi origjinën e kësaj pasurie

34. Referuar akteve të administruara në dosje, ka rezultuar se babai i bashkëshortes, z. J.B, përmes kontratës së shitblerjes¹² datë 5.12.2001, ka blerë një shtëpi dykatëshe me sip. ndërtimi 107.2 m² dhe sip. totale 115 m² + truall të shtetasit H.K, si dhe pjesën “B” të shtëpisë të përbërë prej garazhit me sip. ndërtimi 45 m² dhe sip. oborri 70 m² (pra, gjithsej 115 m²) + truall të shtetasit A.K, në vlerën 4.000.000 lekë, e cila është paguar jashtë zyrës noteriale, e ndarë në 3.000.000 lekë në favor të shtetasit H.K dhe 1.000.000 lekë në favor të shtetasit A.K.
35. Për këtë pasuri z. J.B është pajisur me çertifikatë pronësie në datën 7.11.2006 dhe më pas në datën 2.6.2011 e ka ndarë pronën në 3 apartamente, respektivisht:
 - i) apartament me nr. pasurie ***, me sip. 107.2 m²;
 - ii) apartament me nr. pasurie ***, me sip. 125.53 m²;
 - iii) apartament me nr. pasurie ***, me sip. 106.63 m², e cila posedohet nga subjekti.
36. Për secilën nga këto pasuri, ZVRPP Korçë ka lëshuar çertifikatat respektive të pronësisë në datën 29.7.2011, në emër të shtetasit J.B.
37. Sipas raportit të vlerësimit të kryer në datën 7.12.2011, nga një ekspert vlerësues pasurish të paluajtshme pranë ZVRPP-së Korçë, evidentohet fakti se prona është një ndërtesë e re me 3 kate dhe ky apartament banimi vlerësohet në vlerën 4.851.665 lekë, e cila përputhet me vlerën e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

Lidhur me periudhën e ndërtimit të katit të tretë dhe shtesave anësore

38. Nisur nga fakti se në vitin 2001 vjehrrit i subjektit ka blerë banesë dykatëshe, Komisioni hetoi lidhur me periudhën e ndërtimit të katit të tretë banesës, pasuri në përdorim nga subjekti, si dhe ndërtimin e shtesave anësore në këtë pasuri.
39. Komisioni i ka kërkuar¹³ subjektit të deklarojë nëse ka ndërtime shtesë në këtë pasuri të investuar prej tij dhe nëse po, të deklarojë periudhën e ndërtimit, vlerën e investuar prej tij, si dhe të dokumentojë burimet e ligjshme të investimit. Subjekti ka shpjeguar¹⁴ se në momentin e dhurimit të apartamentit (kati i tretë i banesës private), kohë e cila përkon me momentin pas lidhjes së martesës, objekti në tërësi, përfshirë edhe katin e tretë ishte i ndërtuar, pra ndërtim i përfunduar që në vitin 2004. Subjekti ka shpjeguar se prej tij nuk është kryer asnjë investim për ndërtimet shtesë

¹¹ E depozituar nga subjekti me *email* datë 18.1.2023.

¹² Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 5.12.2001.

¹³ Përmes pyetësorit me *email* datë 13.1.2023.

¹⁴ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 18.1.2023, në përgjigje të pyetësorit datë 13.1.2023.

dhe investimet e tij e të bashkëshortes kanë qenë vetëm në kryerjen e punimeve të nevojshme për ta përshtatur si banesë.

40. Lidhur me periudhën e ndërtimit të katit të 3-të dhe shtesave anësore, nga verifikimi i dokumentacionit në dosje kanë rezultuar faktet si vijojnë:

- i. Në deklarimin para fillimit të detyrës së vitit 2009¹⁵ subjekti ka deklaruar se kati i tretë i banesës është ndërtuar në vitin 2004 dhe tek rubrika “të dhëna konfidenciale”, seksioni “nr. regjistri publik, nr. kontratës, data, muaji, viti”, subjekti ka deklaruar dhurimin e banesës në vitin 2007. Komisioni ka administruar procesverbalet e shpjegimeve të dhëna pranë ILDKPKI-së¹⁶ ku, ndër të tjera, subjekti ka shpjeguar¹⁷ se kjo banesë 3-katëshe është ndërtuar nga vjehri rreth viteve 2002 - 2003 me të ardhurat e përfituara nga shitja e një apartamenti dhe dyqani në Elbasan dhe të ardhurat e tij ndër vite.
- ii. Nga informacioni i dërguar nga ASHK Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë¹⁸ ka rezultuar se shtetasi J.B ka kryer vetëdeklarim pranë ALUIZNI-t me nr. ***, datë 14.9.2006, për legalizim të objektit: “Banesë (shtesë ballkoni) + garazh (shtesë) + mur rrethues”, ku tek seksioni i përshkrimit ka deklaruar: “Në 2 pasuri ka një shtesë ballkoni 9 m² tek objekti 2.5 kate dhe një garazh shtesë me sip. 14 m². Mur rrethues me gjatësi lineare 8.35 m * 4.2 m pronë publike”. Për legalizimin e ndërtimit informal shtetasi J.B është pajisur me lejë legalizimi nr. ***, datë 26.11.2020, për objektin “shtesë anësore dhe në lartësi me funksion të kombinuar në godinën ekzistuese”, si dhe ka paguar tarifat përkatëse të shërbimit dhe të parcelës ndërtimore. Nga praktika e legalizimit evidentohet fakti se për katin e tretë të banesës është lëshuar leja e legalizimit datë 26.11.2020 (për shtesë në lartësi), ndërkohë që për këtë kat të banesës z. B ishte pajisur më herët me çertifikatë pronësie në datën 29.7.2011 (për apartamentin me sip. 106.63 m², nr. pasurie ***), ku duket se ka një gabim/pasaktësi gjatë procesit të legalizimit nga ASHK-ja.
- iii. Pas procedurave të legalizimit, kartela e pasurisë mëmë nr. *** është mbyllur, duke u hapur një kartelë e re pasurie me nr. *** për truallin me sip. 149.6 m² (sipërfaqja ekzistuese 115 m² + shtesa¹⁹ prej 34.6 m²) dhe ndërtesë me sip. 146.1 m² (sipërfaqja ekzistuese 107.2 m² + shtesa²⁰ prej 38.9 m²), ku në kartelë përcaktohet se pas legalizimit të shtesave sipërfaqja e parcelës ndërtimore bëhet 149.6 m², sipërfaqja e katit përdhe dhe e katit të parë 146.3 m² dhe sipërfaqja e katit papafingo 143.4 m².
- iv. Komisioni ka kërkuar informacion pranë Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) lidhur me lartësinë e ndërtimit të banesës për periudhën nga viti 2001 dhe në vijim, e cila ka dërguar²¹ kuotat mbi lartësinë e ndërtimit të nxjerra nga fotografimi ajror i vitit 2007 (data e fotografimit 18.6.2007) dhe vitit 2015 (data e fotografimit 5.7.2015). Nga verifikimi i kryer nuk evidentohen ndryshime lidhur me lartësinë e ndërtimit midis kësaj

¹⁵ Dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.11.2009, periudhë kur subjekti ka qenë prokuror në stazh.

¹⁶ Në shkresën nr. *** prot., datë 26.1.2013.

¹⁷ Në procesverbalin datë 10.2.2016, të mbajtur në ILDKPKI.

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 19.12.2022.

¹⁹ Shtesa e parcelës ndërtimore prej 34.6 m², e regjistruar në kartelën e pasurisë nr. ***, z. k. ***, në bazë të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe lejes së legalizimit nr. ***, datë 26.11.2020.

²⁰ Shtesa e ndërtesës prej 38.9 m², e regjistruar në kartelën e pasurisë nr. ***-ND, z. k. ***, në bazë të lejes së legalizimit nr. ***, datë 26.11.2020.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 23.12.2022, e ASIG-ut.

periudhe, 2007 – 2015. Ndërsa, nga verifikimi i pamjeve fotografike (me ortofoto) të dërguara nga ASIG-u²² për vitet 2007 dhe 2015 evidentohet vetëm një shtesë çatie në katin e 3-të të banesës.

- v. Në DPV-në e vitit 2009 para fillimit të detyrës²³, subjekti ka deklaruar dy kredi të marra pranë NBG Bank, për rikonstruksion shtëpie dhe për mobilim. Komisioni ka administruar dosjet përkatëse të kredive pranë “ABI Bank”²⁴ (e cila ka përthithur NBG-në), ku evidentohet se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë nënshkruar:

- a) një kontratë kredie²⁵ në datën 9.3.2007, për marrjen e një kredie në shumën 12.000 euro, me qëllim blerje/rikonstruksion banese në adresën rruga “K.D”, Lagjja nr. **, nr. *, Korçë;
- b) një kontratë kredie²⁶ datë 2.5.2009, për vlerën e kredisë 2.000.000 lekë, me mobilim shtëpie.

Në dosjet e kredive ndodhen dy raporte vlerësimi të kryera nga ekspertë vlerësues të pasurive të paluajtshme, për qëllim kredidhënie nga banka, ku evidentohet se:

- Në raportin e vlerësimit të datës 21.2.2007, te pika 2 e raportit (përshkrimi i pronës) citohet fakti se: *“Në të dy katet, të gjitha punimet ndërtimore kanë përfunduar, ndërsa në katin e tretë të tipit papafingo ka punime ndërtimore të papërfunduara, si shtresat e dyshemeve, dyert, dritaret, kompletimi i ambientit të banjës, shtrimi i shkallëve të brendshme etj.”*. Nga pamjet fotografike të banesës bashkëlidhur këtij raporti evidentohet kati i tretë i banesës (ndërtim i përfunduar).
- Ndërsa në raportin e vlerësimit të datës 18.5.2011, te përshkrimi i pronës, citohet fakti se: *“Kati i tretë megjithëse ndodhet nën çati nuk mund të quhet papafingo, pasi sipërfaqja është e njëjtë me katin e poshtëm dhe lartësia është normale e uniforme në gjithë sipërfaqen e saj”*. Nga pamjet fotografike të banesës së vitit 2011, duket se ka shtesë çatie në katin e 3-të të banesës.

41. Nga hetimi i kryer duket se kati i tretë i banesës dhe ndërtimet shtesë janë kryer nga vjehri i subjektit para vitit 2007, periudhë para martesës së subjektit në shtator të vitit 2008, si dhe para emërimit të tij në detyrën e prokurorit në nëntor të vitit 2010. Aktet ligjore për apartamentin në përdorim përputhen me deklarinimin e subjektit, pasi kjo pasuri aktualisht është në pronësi të vjehrit të subjektit, e blerë vite përpara martesës në vitin 2001.

Komisioni analizoi burimet e krijimit të pasurisë

42. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se kati i tretë i banesës i është dhuruar nga vjehri (pa dokumente), ndërsa nga aktet e pronësisë kjo pronë *de jure* vijon të jetë e regjistruar në pronësi të vjehrit J.B.
43. Referuar nenit 764 të Kodit Civil, një nga format e fitimit të pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme është edhe dhurimi i pasurisë, i cili duhet të bëhet me akt publik dhe të regjistrohet, në të kundërt konsiderohet i pavlefshëm. Sipas kësaj dispozite ligjore, përfitimi i pronësisë mbi pasuritë, pra për t’u bërë pronar i një sendi të paluajtshëm duhet të plotësohen dy kushte thelbësore, së pari, veprimi

²² Shkresë nr. *** prot., datë 22.12.2022.

²³ Te rubrika “detyrimet financiare”.

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 21.12.2022.

²⁵ Kontratë kredie me nr. ***, datë 9.3.2007.

²⁶ Kontratë kredie nr. ***, datë 2.5.2009.

juridik i dhurimit për kalimin e pronësisë të bëhet me akt noterial dhe së dyti regjistrimin e këtij akti noterial. Mosplotësimi i këtyre dy kushteve e bën subjektin e rivlerësimit Olger Eminaj posedues të sendit të paluajtshëm, pasi në këtë rast mungon veprimi juridik i dhurimit midis palëve.

44. Nisur nga fakti që subjekti me deklaratimet e tij ka konfirmuar marrëdhënien e dhurimit, gjendet në kushtet e parashikuara në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe ka detyrimin ligjor të provojë burimet e ligjshme të dhuruesit (vjehtërit) për pasurinë në përdorim të tij.

44.1 Komisioni hetoi mbi burimet e krijimit për këtë pasuri, duke i kërkuar²⁷ subjektit të deklarojë dhe dokumentojë burimet e ligjshme të vjehtërit, të cilat ka shërbyer për blerjen e kësaj pasurie. Subjekti ka depozituar²⁸ si dokumentacion provues një kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 27.9.2001, të nënshkruar midis shitësit J.B dhe blerësit “Tirana Bank”, përmes së cilës vjehtëri i subjektit ka shitur një pasuri të llojit “njësi” të ndodhur në katin e parë, te bulevardi kryesor “Qemal Stafa” në Elbasan, kundrejt vlerës 16.000.000 lekë, e cila është likuiduar totalisht ndërmjet palëve.

45. Nga të dhënat bankare të dërguara nga “Tirana Bank”²⁹ evidentohet kreditimi i shumës 12.000.000 lekë në datën 27.9.2001 dhe shuma 2.000.000 lekë e kredituar në datën 8.10.2001, në llogarinë e shtetasit J.B, me përshkrimin “pagesë për blerjen e ndërtesës në Elbasan”.

45.1 Kjo shumë është tërhequr nga llogaria bankare e z. B në datën 7.12.2001, 2 ditë pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së banesës në Korçë, në datën 5.12.2001 (për tërheqjen e shumave të konsiderueshme, politika e bankës është që klienti duhet të bëjë një kërkesë për tërheqje 1-3 ditë para).

46. Komisioni verifikoi mbi investime të tjera në pasuri të luajtshme dhe paluajtshme të prindërve të bashkëshortes, ku nga të dhënat³⁰ e administruara në dosje ka rezultuar: (a) një arë me sip. 5.859 m² (nr. pasurie ***) në H, Devoll, e blerë nga shtetasi J.B në datën 25.6.2004, në vlerën 100.000 lekë; (b) një automjet tip “Audi **”, i blerë në datën 15.8.2007 kundrejt vlerës 200.000 lekë, ku z. J.B është regjistruar bashkëpronar së bashku me shtetasin P.F; (c) një automjet tip Volkswagen Passat”, i blerë nga në datën 4.3.2002 kundrejt vlerës 140.000 lekë, plus zhdoganimi i mjetit në vlerën 131.529 lekë.

47. Nga hetimi i kryer duket se të ardhurat nga shitja e pronës në Elbasan janë të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie në Korçë.

Lidhur me shpenzimet e mobilimit

48. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka shpjeguar se shpenzimet për mobilimin e banesës ku jeton janë kryer në dy faza, konkretisht, në vitet 2009 - 2010 dhe në vitin 2016.

49. Subjekti ka deklaruar se në korrik të vitit 2009 (disa muaj para marrjes së detyrës) së bashku me bashkëshorten kanë marrë pranë ish-bankës NBG një kredi në shumën 2.000.000 lekë, ku nga kjo shumë 600.000 lekë³¹ u përdorën për shlyerjen e një kredie, marrë në vitin 2008, dhe pjesa e mbetur

²⁷ Përmes pyetësorit me *email* datë 18.11.2022.

²⁸ Përgjigjja e subjektit me *email* datë 25.11.2022.

²⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 7.4.2021.

³⁰ Shkresat: nr. *** prot., datë 23.12.2022, e ASHK-së Devoll; nr. *** prot., datë 23.11.2022, e ASHK-së Devoll; nr. *** prot., datë 12.2.2016, e DPSHTRR-së.

³¹ Në procesverbalin e datës 10.2.2016, të mbajtur në ILDKPKI, dërguar pranë Komisionit me shkresën nr. *** prot., datë 26.1.2023, subjekti është pyetur lidhur me kredinë prej 600.000 lekësh, marrë pranë NBG-së në datën 1.7.2008, për të cilën ka shpjeguar se kjo kredi ka pasur si qëllim mbulimin e shpenzimeve të dasmës dhe pushimeve dhe pasi kanë marrë edhe kredinë prej

rreth 1.400.000 lekë u përdorën për përfundim punimesh ndërtimi dhe mobilim të banesës (kati i tretë). Subjekti ka saktësuar se shpenzimet e mobilimit për periudhën 2009 - 2010 janë përafërsisht në vlerën 850.000 lekë për mobilim banese, ku përfshihet dhomë gjumi, kuzhinë, mobilie korridor, mobilie dhomë ndenje etj., dhe rreth 300.000 lekë për pajisje elektroshtëpiake dhe pagesat e shpenzimeve janë kryer *cash*.

50. Ndërsa për shpenzimet e kryera në vitin 2016, subjekti ka shpjeguar se në qershor të vitit 2016 ka marrë kredi së bashku me bashkëshorten në vlerën 1.020.000 lekë, në “Raiffeisen Bank”, e cila është përdorur për blerje orendi shtëpiake, kryerje punimesh ndërtimi për rregullimin e oborrit të banesës, blerje paneli diellor, kaldajë etj., duke saktësuar se shuma 280.000 lekë është përdorur për mobilie trapezari, karrige dhe orendi të tjera, shuma 150.000 lekë për panelin diellor, shuma 120.000 lekë për kaldajë. Këto shpenzime i përkasin periudhës qershor - tetor 2016. Blerjet janë kryer në subjekte të ndryshme tregtare dhe nuk disponon fatura.
51. Këto shpenzime të deklaruara janë reflektuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

Konstatime të Komisionit për pasurinë në përdorim

52. Nga hetimi i kryer u konstatua se:

- pasuria banesë në Korçë është blerë nga babai i bashkëshortes në vitin 2001, shumë kohë përpara martesës së subjektit dhe emërimit të subjektit në detyrën e prokurorit në vitin 2010;
- nga analizimi i burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie subjekti provoi të ardhurat e ligjshme të vjehrrit, në momentin e blerjes dhe ndërtimin e shtesave në të.

- 53. Automjet³² tip “Volkswagen Golf”, i blerë në datën 2.9.2011, në vlerën 150.000 lekë**

54. Komisioni ka kërkuar informacion pranë DPSHTRR-së³³, e cila ka konfirmuar automjetin në pronësi të subjektit Olger Eminaj. Nga verifikimi i dosjes³⁴ përkatëse të automjetit ka rezultuar se subjekti ka nënshkruar me shtetasin E.K kontratën e shitblerjes³⁵ datë 2.9.2011, për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Golf”, me targa AA *** AZ, vit prodhimi 2001, kundrejt çmimit njëqind e pesëdhjetë mijë lekë³⁶. Subjekti e ka deklaruar këtë automjet në deklarinimin periodik vjetor të vitit 2011, me vlerë 150.000 lekë, me burim kursimet nga paga.

2.000.000 lekësh për rregullimin përfundimtar të banesës dhe mobilimin e saj, një pjesë e kësaj kredie u përdor për mbylljen e kredisë prej 600.000 lekësh.

³² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dokumentet vijuese: (1) vërtetim datë 25.10.2016, nga DPSHTRR-ja Drejtoria Rajonale Korçë për automjetin me targë AA *** AZ, regjistruar në emër të z. Olger Eminaj, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 2.9.2011; (2) kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 2.9.2011, me palë shitëse E.K dhe palë blerëse Olger Eminaj, të një automjeti tip “Volkswagen Golf”, me targë BW *** DR, kundrejt vlerës 1.500.000 lekë (njëqind e pesëdhjetë mijë), shumë e cila është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale; (3) deklarata e zhdoganimit të automjetit datë 2.9.2011, me vlerë të faturuar 800 euro dhe detyrime doganore 25.231 lekë; (4) leja e qarkullimit të automjetit me targë AA *** AZ, tip “Volkswagen Golf”, vit prodhimi 2001, regjistruar në emër të subjektit Olger Eminaj.

³³ Shkresë nr. *** prot., datë 24.3.2021.

³⁴ Dosja e automjetit me targë AA *** AZ: shkresa nr. *** prot., datë 11.8.2017 e DPSHTRR-së drejtuar Drejtorisë Rajonale Korçë; leja e qarkullimit rrugor dhe të dhënat lidhur me të datë 8.9.2011; faturë shërbimi nr. ***, datë 8.9.2011; certifikatë e kontrollit fizik të mjetit në emër të subjektit Olger Eminaj datë 7.9.2011; dokument hyrje (lejë qarkullimi provizor) nr. *** prot., datë 2.9.2011; urdhër çlirimi (faturë nr. ***); mandatarkëtimi me shumë 32.903 lekë; faturë zhdoganimi datë 2.9.2011; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 2.9.2011; rezultatet e kërkimit nga regjistri i barrëve siguroese datë 5.9.2011; certifikatë pronësie nr. *** dhe autocertifikim datë 30.5.2011, me vërtetim përkthimi dhe nënshkrimi nr. *** rep., datë 2.9.2011; kartë qarkullimi; vërtetim nr. *** regj., datë 6.9.2011, e lëshuar nga Bashkia Korçë.

³⁵ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 2.9.2011.

³⁶ Në kontratën e shitjes duket se ka një gabim material tek çmimi i blerjes së automjetit, i cili shënohet 1.500.000 lekë, ndërsa në kllapa përshkruhet me fjalë vlere “njëqind e pesëdhjetë mijë lekë”.

55. Komisioni verifikoi lidhur me çmimin e blerjes së automjetit, ku nga aktet në dosje ka rezultuar se shitësi E.K e ka blerë këtë automjet në datën 30.5.2011, në vlerën 800 euro, si dhe ka paguar zhdoganimin e tij në vlerën 32.903 lekë. Sipas faturës së zhdoganimit të lëshuar në datën 2.9.2011 vlera e automjetit përcaktohet në shumën 800 euro (me kurs këmbimi 1 euro = 140.19 lekë).
56. Nga hetimi i kryer nuk u evidentua ndonjë trajtim preferencial lidhur me çmimin e blerjes së automjetit.
57. Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit me shitësin, ku nga përgjigjja e ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë³⁷ nuk kanë rezultuar procedime penale në emër të këtij shtetasi.

Komisioni ka analizuar burimin e krijimit të pasurisë

58. Në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, ndërsa në vitin e blerjes, në deklarinimin periodik vjetor (në vijim DPV) të vitit 2011, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat nga pagat.

Konstatime të Komisionit për automjetin

59. Nga hetimi i kryer ka rezultuar se:
- Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar nga DPSHTRR-ja.
 - Nga analiza e kryer nga Komisioni, referuar tabelës së përgjithshme të analizës financiare të vitit 2011, ka rezultuar se subjekti ka pasur burime të ligjshme për blerjen e automjetit.
- 60. Tokë bujqësore³⁸**, përfituar nga ligji nr. 7501, viti 1991, si anëtar i familjes bujqësore, sip. 30.000 m², me pjesë takuese 20%. Kjo pasuri është regjistruar në emër të babait, si kryefamiljar.
- 60.1 Zyra Vendore e ASHK-së Kolonjë ³⁹ ka informuar se në emër të shtetasit Olger Eminaj nuk rezultojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi, ndërsa në emër të babait të subjektit V.E, në cilësinë e përfaqësuesit të familjes bujqësore, figuron pasuria “arë + pemëtores”, me sipërfaqe totale 30.000 m², sipas AMTP-së nr. ***, datë 31.12.1991, në zonën kadastrale ***, fshati S, Bashkia Kolonjë.
- 60.2 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar pasurinë tokë bujqësore të përfituar me ligjin nr. 7501, viti 1991, si anëtar i familjes bujqësore, me pjesë takuese 20 %.
- 60.3 Subjekti ka paraqitur certifikatën familjare të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Ersekë në datën 25.1.2017, ku në përbërjen familjare të datës 1.8.1991 figurojnë 5 anëtarë të familjes bujqësore, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit Olger Eminaj.
- 60.4 Referuar parashikimeve ligjore, nga pasuria e paluajtshme e përfituar nga babai V.E. si kryefamiljar, subjekti zotëron 20% pjesë nga kjo pasuri.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 19.1.2023.

³⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (1) aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. ***, datë 31.12.1991, familjes së V.E në fshatin S, Rrethi Kolonjë, tokë gjithsej me sip. 30.000 m²; (2) vërtetim i njësisë me origjinalin nr. *** rep., datë 27.1.2017, të dokumentacionit të mësipërm; (3) certifikatë e përbërjes familjare datë 1.8.1991.

³⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 22.12.2022.

60.5 Nga hetimi i Komisionit, deklarimi i subjektit përputhet me informacionin e ardhur nga ASHK-ja Kolonjë dhe konfirmohet se kjo pasuri është përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991.

VERIFIKIME TË TJERA NGA KOMISIONI

61. Komisioni verifikoi llogaritë bankare të subjektit dhe bashkëshortes

61.1 Nga informacioni i ardhur nga institucionet bankare⁴⁰ kanë rezultuar disa llogari bankare (llogari rrjedhëse, page, llogari kursimi e kredie) të çelura ndër vite nga subjekti Olger Eminaj dhe bashkëshortja e tij.

61.2 Nga hetimi i Komisionit nuk kanë rezultuar problematika lidhur me të dhënat e llogarive bankare. Subjekti duhej të deklaronte gjendjet e likuiditeteve të këtyre llogarive në deklaratimet periodike vjetore dhe në deklaratën *Vetting*, sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 4, germa “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

62. Komisioni verifikoi lidhur me transaksionet e bashkëshortes së subjektit

62.1 Nga informacioni i ardhur nga Raiffeisen Invest⁴¹ ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit O.E ka qenë investitore në F.P dhe në datën 5.10.2016 ka bërë shitje totale të kuotave.

62.2 Referuar nxjerrjes së llogarisë për periudhën 23.5.2016 – 22.3.2021, bashkëshortja ka investuar vlerën 53.226 lekë në datën 23.5.2016, vlerën 350.000 lekë në datën 10.6.2016 dhe në datën 5.10.2016 ka bërë shitje totale të kuotave me vlerë 409.427.36 lekë.

62.3 Komisioni i ka kërkuar⁴² subjektit të deklarojë burimin e investimit të bashkëshortes në këtë fond investimi me shumë 403.336 lekë në vitin 2016 dhe destinacionin e kësaj shume pas tërheqjes.

62.4 Subjekti ka shpjeguar⁴³ se kjo shumë e investuar ka si burim kredinë prej 1.000.000 lekësh të marrë pranë “Raiffeisen Bank” në vitin 2016, ku një pjesë e kredisë së marrë është përdorur për investime në objektin 3-katësh (si blerje paneli diellor, lysterje e gjithë objektit nga jashtë, sistemim dhe shtrim i oborrit etj.), ndërsa pjesa e papërdorur e kredisë që përkon me shumën rreth 403.000 lekë është lënë përkohësisht në fond investimi pranë kësaj banke.

62.5 Sa i përket destinacionit të kësaj shume, subjekti ka shpjeguar se kjo shumë është tërhequr në tetor të vitit 2016 dhe është përdorur për plotësim mobilimi të katit të tretë, blerje kaldaje dhe meremetime të tjera të objektit.

62.6 Në DPV-në e vitit 2016 bashkëshortja e subjektit nuk e ka deklaruar këtë fond investimi nisur nga fakti se investimi në f.p është kryer brenda vitit periodik 2016.

62.7 Nga hetimi i kryer nuk u evidentuan problematika.

⁴⁰ 1) Shkresë nr. *** prot., datë 8.4.2021, e “Raiffeisen Bank”; (2) shkresë nr. *** prot., datë 31.3.2021, e “Union Bank”; (3) shkresë nr. *** prot., datë 26.3.2021, e BKT-së; (4) shkresë nr. *** prot., datë 9.4.2021, e “Intesa Sanpaolo Bank”; (5) shkresë nr. *** prot., datë 31.5.2021, e “Credins Bank”; (6) shkresë nr. *** prot., datë 25.3.2021, e “ABI Bank”; (7) shkresë nr. *** prot., datë 7.4.2021, e “Tirana Bank”.

⁴¹ Shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2021.

⁴² Përmes pyetësorit me *email* datë 13.1.2023.

⁴³ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 18.1.2023, në përgjigje të pyetësorit datë 13.1.2023.

63. Komisioni analizoi kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti

63.1 Subjekti ka deklaruar në vitin 2009 kursime *cash* të kursyera nga pagat e tij dhe të bashkëshortes në shumat 3.800 euro⁴⁴ dhe 400 euro⁴⁵ dhe në DPV-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar kursime *cash* në vlerën 1.800 euro, me pjesë takuese 50%. I pyetur⁴⁶ nga Komisioni mbi përdorimin e këtyre shumave, subjekti ka shpjeguar⁴⁷ ndër të tjera se kursimet e mbledhura deri në plotësimin e deklaratës para fillimit të detyrës, si dhe ato të mbledhura më pas deri në DPV-në e vitit 2010 janë shpenzuar për përfundimin e punimeve të brendshme të objektit të dhuruar, si dhe mobilimin e tij.

63.2 Referuar nenit 4, germa “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, i ndryshuar, subjektet detyrohen të deklarojnë vlerën e likuiditeteve, si dhe gjendjen *cash*, në lekë ose në valutë të huaj. Në këtë kuptim, në formularin e deklarimit të pasurisë, në seksionin e ndryshimeve të interesave private kërkohet nga deklaruesit që të pasqyrojnë ndryshimet (shtesa dhe pakësime) për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në datën 31 dhjetor të vitit të deklarimit. Nga verifikimi i kryer evidentohet se subjekti nuk ka deklaruar pakësim të këtyre kursimeve.

63.3 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën 2007 – 2009 ka rezultuar një balancë pozitive dhe se subjekti dhe bashkëshortja e tij kishin mundësitë për krijimin e këtyre kursimeve.

64. Komisioni hetoi lidhur me banesat në përdorim nga ana e subjektit

64.1 Në pyetësonin standard subjekti ka deklaruar se nga momenti i marrjes së detyrës (datë 12.10.2009) dhe deri sot ka jetuar në banesën në emër të vjehrrit, në adresën “Lagjja nr. **, rruga ‘K.D’, nr. *, Korçë”.

64.2 Nga verifikimi i deklarimeve periodike nga viti 2009 dhe në vijim, subjekti ka deklaruar të njëjtën adresë vendbanimi “Lagjja nr. **, rruga ‘K.D’, banesë private nr. *, Korçë”, e cila përkon me adresën e banesës në përdorim nga subjekti (kati i tretë i banesës), në pronësi të vjehrrit të tij.

64.3 Nga hetimi i kryer nuk u evidentuan problematika lidhur me banesat në përdorim.

65. Komisioni hetoi lidhur me automjetet në përdorim

65.1 Gjatë hetimit, subjekti ka deklaruar⁴⁸ përdorimin e një automjeti me targë KO *** B, në pronësi të vjehrrit, që prej marrjes së detyrës deri në maj të vitit 2011. Nga verifikimi në sistemin e AMF-së, subjekti Olger Eminaj ka rezultuar përdorues i këtij automjeti në policën e sigurimit për periudhën 14.12.2010 – 13.12.2011.

65.2 Nga verifikimi i dosjes së automjetit të dërguar nga DPSHTRR-ja⁴⁹ ka rezultuar se ky automjet është blerë nga vjehrrin i tij J.B në datën 15.8.2007 (periudhë para emërimit të subjektit në detyrën e prokurorit në nëntor të vitit 2010), ku z. B është bashkëpronar së bashku me shtetasin P.F (mik i tij).

⁴⁴ Në DPV-në e vitit 2009 para fillimit të detyrës.

⁴⁵ Në DPV-në e vitit 2009.

⁴⁶ Përmes pyetësonit me *email* datë 13.1.2023.

⁴⁷ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 18.1.2023, në përgjigje të pyetësonit datë 13.1.2023.

⁴⁸ Përgjigjet e pyetësonit standard.

⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 24.3.2021.

65.3 Gjithashtu, nga verifikimi në sistemin e AMF-së, subjekti Olger Eminaj ka rezultuar përdorues në policën e sigurimit të një automjeti tip “H.C”, me vit prodhimi 2002 dhe targë AA *** FD për periudhën 9.3.2013 - 8.3.2014, me pronar shtetasin L.B.

65.4 Komisioni i ka kërkuar⁵⁰ subjektit të deklarojë marrëdhënien që ka me këtë shtetas, si dhe të shpjegojë arsyen e mosdeklarimit të përdorimit të këtij automjeti në pyetësonin standard. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar⁵¹ ndër të tjera se shtetasi L.B është fqinjë me shtetasin P.F, të cilit i ka përdorur automjetin dhe me këtë shtetas nuk ka pasur asnjë marrëdhënie tjetër përveç njohjes në rrethanat e mësipërme. Sa i përket vendosjes së emrit si “përdorues” në policë sigurimi, subjekti ka shpjeguar⁵² se nuk i kujtohet asnjë rrethanë ku mund t’i jetë vendosur emri i tij në atë dokument, pasi nuk e ka përdorur asnjëherë këtë automjet, as si pasagjer. Subjekti ka shpjeguar se në periudhën kur ka qenë e vlefshme polica e sigurimit 2013 - 2014 ka pasur në pronësi automjetin e tij dhe nuk ka pasur nevojë për të përdorur automjetin e shtetasit L.B. Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues shkresën nr. *** prot., datë 30.1.2023, të DPSHTRR-së Korçë, e cila konfirmon se z. Olger Eminaj gjatë periudhës 2013 - 2014 ka paguar detyrimet e tij për automjetin e tij me targë AA *** AZ.

65.5 Komisioni ka hetuar lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi midis subjektit dhe pronarëve të automjeteve, ku nga verifikimi i kryer⁵³ nuk u evidentua ndonjë nga rastet e parashikuara në ligj.

65.6 Nga hetimi i kryer lidhur me automjetet në përdorim nuk u evidentuan problematika.

66. Komisioni verifikoi të dhënat e gjeneruara nga sistemi TIMS⁵⁴ në lidhje me udhëtimet e kryera nga subjekti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, automjetet dhe personat me të cilët ka udhëtuar, për të cilat subjekti ka dhënë shpjegimet⁵⁵ përkatëse për secilin automjet me të cilin ka udhëtuar jashtë territorit dhe marrëdhënien që ka me pronarët e automjeteve.

66.1 Nga hetimi i kryer duket se shpjegimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e gjeneruar nga sistemi TIMS dhe me verifikimet e targave sipas të dhënave nga sistemi i AMF-së.

DETYRIME FINANCIARE

67. Në deklaratën *Vetting*, tek rubrika “detyrimet financiare”, subjekti ka deklaruar:

68. **Kredi bankare⁵⁶ në NBG**, marrë në datën 9.3.2007, në shumën 12.000 euro, me afat 15 vjet, me qëllim rikonstrukcion banese. Detyrimi i pashlyer është deklaruar në shumën 5.155 euro.

⁵⁰ Përmes pyetësorit me *email* datë 27.1.2023.

⁵¹ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 31.1.2023.

⁵² Shpjegimet e subjektit me *email* datë 31.1.2023.

⁵³ Referuar shkresës nr. *** prot., datë 19.1.2023 dhe shkresës nr. *** prot., datë 30.1.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë (të regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 23.1.2023 dhe të depozituar nga subjekti në datën 31.1.2023).

⁵⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.3.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

⁵⁵ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 23.1.2023.

⁵⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentet vijuese: (1) vërtetim datë 25.1.2017 nga NBG-ja, drejtuar shtetasve O.E dhe Olger Eminaj, e cila konfirmon për kredinë me vlerë 12.000 euro, sipas kontratës datë 9.3.2007, me qëllim rikonstrukcion banese, afati 15 vjet. Gjendja e llogarisë datë 25.1.2017, në shumën 5.155,45 euro; (2) kontratë kredie nr. ***, datë 9.3.2007, palë kredidhënëse Banka Kombëtare e Greqisë dhe palë kredimarrëse O.B e Olger Eminaj, dorëzanës J.B e A.B, të kredisë në shumën 12.000 euro, me qëllim blerje/rikonstrukcion të banesës në adresën në rruga “K.D”, Lagjja nr. **, nr. *, Korçë. Shuma e kredisë do të disbusohet me dy këste. Kredimarrësit/dorëzantësit marrin përsipër vendosjen si garanci në favor të bankës të pasurisë nr. ***, z. k. ***, me adresë në Korçë. Prona është e regjistruar në pronësi të shtetasit J.B, sipas certifikatës së pronësisë datë 7.11.2006;

68.1 Nga informacioni i dërguar nga “ABI Bank”⁵⁷ konfirmohet llogaria e kredisë në euro në emër të bashkëshortes O.E, e hapur pranë ish-NBG-së në datën 20.3.2007.

68.2 Komisioni ka administruar dosjen përkatëse të kredisë⁵⁸ së marrë pranë ish-NBG-së nga kredimarrësit Olger Eminaj dhe O.E, ku nga verifikimi i kryer ka rezultuar se kredia është disbursuar në datën 20.3.2007 dhe është mbyllur më 24.4.2020.

68.3 Nga verifikimi i deklarimeve periodike për periudhën 2009 – 2016, tek rubrika e “detyrimeve financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë” subjekti ka deklaruar shumën e kredisë prej 12.000 euro, si dhe gjendjen e detyrimit të mbetur të pashlyer për çdo vit.

68.4 Nga hetimi i kryer, përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga banka.

69. Kredi bankare⁵⁹ në NBG, datë 2.5.2009, në shumën e disbursuar 2.000.000 lekë, me qëllim mobilim shtëpie, afati 10 vjet. Detyrimi i pashlyer është deklaruar në shumën 610.430,26 lekë.

69.1 “ABI Bank”⁶⁰ ka konfirmuar llogarinë e kredisë në lekë në emër të shtetasës O.E, të hapur pranë ish- NBG Bank. Komisioni ka administruar dosjen përkatëse të kredisë ⁶¹ në shumën 2.000.000 lekë të marrë pranë ish-NBG-së, ku përcaktohet se qëllimi i kësaj kredie është për mobilim shtëpie.

69.2 Nga verifikimi i deklarimeve periodike për periudhën 2009 – 2016, tek rubrika “detyrimet financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë”, subjekti ka deklaruar shumën e kredisë prej 2.000.000 lekësh, si dhe gjendjen e detyrimit të mbetur të pashlyer për çdo vit.

69.3 Nga hetimi i kryer, përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga banka.

70. Kredi⁶² në “Raiffeisen Bank” në datën 7.6.2016, në shumën e disbursuar 1.020.000 lekë, për qëllime personale, me afat 36 muaj. Detyrimi i pashlyer është deklaruar në shumën 869.106,81 lekë.

(3) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, z. k. ***, të pasurisë truall me sip. 115 m², nga e cila ndërtesë me sip. 107.2 m², në emër të shtetasit J.B, ndodhur në z. k. ***, Korçë. Data e lëshimit të certifikatës 7.11.2006.

⁵⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.3.2021.

⁵⁸ Dërguar nga “ABI Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 21.12.2022.

⁵⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentet vijuese: (1) vërtetim datë 25.1.2017, nga NBG-ja, drejtuar O.E dhe Olger Eminaj për kredinë me vlerë 2.000.000 lekë, sipas kontratës datë 2.5.2009, me qëllim mobilim shtëpie, afati 10 vjet. Gjendja e llogarisë datë 25.1.2017, në shumën 610.430,26 lekë; (2) kontratë kredie nr. ***, datë 2.5.2009, palë kredidhënëse Banka Kombëtare e Greqisë dhe palë kredimarrëse O (E) B e Olger Eminaj, dorëzanës J.B e A.B, për kredinë në shumën 2.000.000 lekë, me qëllim mobilim shtëpie. Shuma e kredisë do të disbursohet me një këst. Kredimarrësit/dorëzanësit marrin përsipër vendosjen si garanci në favor të bankës të pasurisë nr. ***, të ndodhur në z. k. ***, me adresë në Korçë. Prona është e regjistruar në pronësi të shtetasit J.B, sipas certifikatës së pronësisë datë 7.11.2006; (3) kontratë hipoteke nr. ***, datë 2.5.2009, përfitues Banka Kombëtare e Greqisë dhe hipotekues J.B e A.B, për sigurimin e pagimit të kredisë me vlerë 2.000.000 lekë, sipas kontratës së kredisë nr. ***, datë 2.5.2009, duke vendosur si hipotekë e nivelit të dytë në favor të bankës pasurinë nr. ***, të ndodhur në z. k. ***, me adresë në Korçë. Prona është e regjistruar në pronësi të shtetasit J.B, sipas certifikatës së pronësisë datë 7.11.2006; (4) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, z. k. ***, të pasurisë truall me sip. 115 m², nga e cila ndërtesë me sip. 107.2 m², në emër të shtetasit J. B, ndodhur në z. k. ***, Korçë. Data e lëshimit të certifikatës 7.11.2006. Kartela e pasurisë së paluajtshme + harta treguese e regjistrimit.

⁶⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 25.3.2021.

⁶¹ Dërguar nga “ABI Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 21.12.2022.

⁶² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (1) vërtetim datë 25.1.2017 nga “Raiffeisen Bank”, e cila konfirmon se kredimarrësit O. E dhe Olger Eminaj kanë aplikuar për kredi personale në shumën 1.020.000 lekë, disbursuar në datën 7.6.2016, afati 36 muaj. Detyrimi i kredisë në datën 27.1.2017, në shumën 869.106 lekë. Bashkëlidhur ndodhet plani i amortizimit të kredisë; (2) kontratë kredie bankare datë 6.6.2016, e lidhur midis kredidhënësit “Raiffeisen Bank” dhe bashkëkredimarrësve O.E e Olger Eminaj, për kredinë me vlerë 1.020.000 lekë. Qëllimi i dhënies së kredisë është për përdorim personal.

70.1 Nga informacioni i ardhur nga “Raiffeisen Bank”⁶³ konfirmohet kredia në shumën 1.020.000 lekë, e marrë nga bashkëshortja O.E me kontratën e kredisë së lidhur në datën 6.6.2016 dhe mbyllur në datën 7.6.2019, ku qëllimi i kredisë është për arsye personale.

70.2 Subjekti ka deklaruar shumën e kredisë, si dhe detyrimin e mbetur të pashlyer në deklarin periodik vjetor të viteve 2016 dhe 2017.

70.3 Nga hetimi i kryer, përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga banka.

71. Kredi *overdraft*⁶⁴ në “Credins Bank”, me detyrim financiar të pashlyer në shumën 195.000 lekë.

71.1 “Credins Bank”⁶⁵ ka konfirmuar llogarinë e pagës në emër të subjektit O.E. Nga hetimi i kryer, deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar nga banka.

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 8.4.2021.

⁶⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: vërtetim datë 25.1.2017 nga “Credins Bank”, e cila konfirmon se Olger Eminaj në datën 24.10.2016 është financuar me paradhënie bankare për pagamarrës, me afat 12-mujor, në shumën 195.000 lekë. Detyrimi financiar në datën 24.1.2017, në shumën 195.000 lekë.

⁶⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 31.5.2021.

Tabela e analizës financiare të përgjithshme për periudhën 2007 – 2016

PASURITE deklaruar ne Vetting	2007-2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	533 958	216 737	194 274	-143 043	18 456	25 039	1 043	-12 166
Shtepi dhuruar nga J.B								
Automjet i blere ne 02.09.2011 - 150.000 leke			150 000					
Toke bujqesore 30,000 m2								
<i>Shtesa/Pakesime likuiditete</i>	<i>533 958</i>	<i>216 737</i>	<i>44 274</i>	<i>(143 043)</i>	<i>18 456</i>	<i>25 039</i>	<i>1 043</i>	<i>(12 166)</i>
Likuiditete Gjendje	512 352	729 089	773 363	630 320	648 776	673 814	674 857	662 691
DETYRIME	4 050 920	-	-	-	-	-	-	1 020 000
Kredi 12.000 euro 01.03.2007 - NBG bank	1 450 920							
Kredi 2.000.000 leke 01.07.2009 - NBG bank	2 000 000							
Kredi 600.000 leke 1.07.2008 - NBG bank	600 000							
Kredi personale 1.020.000 leke, 07.06.2016								1 020 000
PASURI NETO	(3 516 962)	216 737	194 274	(143 043)	18 456	25 039	1 043	(1 032 166)
TE ARDHURA	2 086 670	1 348 707	1 614 190	1 581 434	1 236 648	1 666 821	1 472 537	1 782 923
Te ardhura nga paga e subjektit	1 129 187	507 570	807 593	1 051 474	885 951	983 908	1 063 087	1 175 948
Te ardhura nga paga e b/shortes	957 483	841 137	806 597	529 960	350 697	682 913	409 450	601 704
Te ardhura nga fondi i investimit RZB								5 271
SHPENZIME	4 837 041	1 031 520	793 120	972 495	894 879	952 929	1 442 070	2 306 428
Shpenzime jetese	531 978	273 240	273 240	279 096	282 048	439 996	448 552	470 184
Shpenzime udhetimi TIMS	182 128	19 433	81 597	262 674	82 724	80 563	15 142	115 656
Shpenzime mobilimi / rinovimi	2 550 920	300 000						1 020 000
Shpenzime kredie 12.000 euro	387 543	153 246	152 683	154 251	154 792	154 681	151 966	149 338
Shpenzime/keste kredie 2.000.000 leke	766 600	285 600	285 600	276 475	375 315	277 688	279 000	302 000
Shpenzime/keste kredie 1.020.000 leke								157 240
Shpenzime te tjera me kredine e 2008	417 872							
Shpenzime spitalore							547 411	92 010
REZULTATI FINANCIAR	766 591	100 451	626 796	751 982	323 313	688 854	29 424	508 661

72. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën 2007 – 2016, duket se subjekti ka pasur burime të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet.

Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë

73. Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se subjekti ka deklaruar saktë pasuritë në deklaratën *Vetting* dhe nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë. Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, ka pasur burime financiare të ligjshme dhe të mjaftueshme, nuk ka kryer deklaram të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, si dhe nuk gjendet në situatë konflikti interesi. Përfundimisht, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

74. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

75. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.
76. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, DSIK-ja ka dërguar një raport⁶⁶ në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit Olger.V.Eminaj*. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.
77. Në vijim, Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruar nga autoritetet verifikuese, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit dhe në raportin me nr. *** prot., datë 20.5.2021⁶⁷ nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës ka konstatuar *papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Olger Eminaj*.
78. Sipas informacionit që disponohet nga autoritetet verifikuese në raportin e përditësuar, ndër të tjera, citohet se gjatë periudhës në të cilën z. Olger Eminaj ushtronte detyrën si prokuror, disponohen të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, kryesisht atë të shpërdorimit të detyrës dhe korrupsionit për shkak të funksionit të tij.

Hetimi i kryer nga Komisioni

79. Në lidhje me raportin e dërguar nga DSIK-ja me nr. *** prot., datë 20.5.2021, sipas të cilit disponohen të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, kryesisht atë të shpërdorimit të detyrës dhe korrupsionit për shkak të funksionit të tij, Komisioni, pasi u njoh me informacionin e disponuar nga autoriteti verifikues, ka kryer verifikimin përkatës ku konstatoi se informacioni i organeve ligjzbatuese nuk përputhet me hetimin e kryer dhe aktet e administruara në dosje.
80. Lidhur me figurën, nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Vlerësimi i Komisionit

81. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
82. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit Olger Eminaj arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të

⁶⁶Raporti për kontrollin e figurës i përcjellë nga DSIK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017.

⁶⁷I deklasifikuar pjesërisht me vendim nr. *** , datë 11.6.2021, të KDZH-së.

germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

83. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit⁶⁸ të hartuar nga KLP-ja për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

84. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- formularit të vetëdeklarimit, 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- të dhënave nga burimet arkivore të prokurorisë/ve.

85. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet si vijon:

i. Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit⁶⁹

Formulari paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar, pa mangësi e kundërthënie, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Përvoja profesionale

Sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se në periudhën tetor 2009 - tetor 2010 subjekti ka ushtruar funksionin e prokurorit stazhier në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe nga nëntori i vitit 2010 e në vazhdim ushtron funksionin e prokurorit në këtë prokurori.

iii. Analizimi i dosjeve të përzgjedhura me short

Gjatë periudhës së rivlerësimit subjekti i rivlerësimit Olger Eminaj ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Komisioni ka analizuar 3 dokumentet ligjore, si dhe 5 dosjet e përzgjedhura me short, ku nga vëzhgimi i tyre nuk u konstatuan problematika thelbësore lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale. Vetëm për njëjërën nga dosjet e vëzhguara, konkretisht dosja 2, evidentohet mungesë e aktit të njoftimit të personit nën hetim lidhur me zgjatjet e afatit të hetimeve, si dhe lidhur me komunikimin e vendimit të pushimit.

⁶⁸ Raporti i miratuar me vendimin nr. ***, datë 19.12.2022, të KLP-së.

⁶⁹ Formulari i vetëdeklarimit është plotësuar nga subjekti i rivlerësimit për 3 vitet e fundit kalendarik 2014, 2015 dhe 2016, ndërsa vetëm në tetor të vitit 2017 është vendosur në bashkëpunim me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit që të dhënat statistikore të subjekteve të rivlerësimit të jepen për 3 vitet e fundit nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, që përkon me periudhën 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016.

Në lidhje me këtë konstatim subjektit iu kërkuan shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

86. Subjekti i rivlerësimit përmes prapësimeve të paraqitura në datën 3.3.2023 ka shpjeguar se pas studimit të dosjes përkatëse që i përket procedimit penal nr. ***, viti 2015, regjistruar për veprën penale “ndryshim në aparatet matëse”, parashikuar nga neni 182 i Kodit Penal, ka konstatuar se nuk e ka kryer njoftimin e personit nën hetim për vendimmarrjen e tij për zgjatjen e afatit të hetimit. Subjekti ka shpjeguar se kjo rrethanë ka ndodhur nga një pakujdesi e tij, nisur edhe nga fakti që në rastin konkret është përfunduar procedimi penal me vendim pushimi. Sa i përket konstatimit të Komisionit për mosnjoftimin e personit nën hetim për vendimin e pushimit, subjekti pretendon se ky konstatim nuk është i vërtetë, pasi në dosjen përkatëse ndodhet shkresa nr. *** prot., datë 24.3.2016, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë e firmosur nga Drejtuesi i Prokurorisë së asaj kohe, të cilën subjekti e ka vendosur në dispozicion të Komisionit, ku evidentohet që personit nën hetim i është dërguar vendimi i pushimit të çështjes.

Vlerësimi i Komisionit

87. Komisioni, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, vlerëson se është detyrë e prokurorit që të marrë të gjitha masat e nevojshme për realizimin e veprimeve hetimore konform ligjit. Megjithatë, kjo mangësi e konstatuar nga Komisioni, si dhe e pranuar nga subjekti si një pakujdesi, vlerësohet si e pamjaftueshme për ta kualifikuar subjektin me mangësi profesionale.
88. Sa i përket mungesës së aktit të njoftimit të personit nën hetim për vendimin e pushimit, në prapësime subjekti arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, ku përmes shkresës nr. *** prot., datë 24.3.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila mungonte në dosjen penale të administruar, si pjesë e raportit të vlerësimit të KLP-së, provohet njoftimi i shtetasit nën hetim për vendimin e pushimit.

TË DHËNAT ARKIVORE (ankesat dhe masat disiplinore)

89. Referuar të dhënave arkivore ka rezultuar se ndaj prokurorit Olger Eminaj është marrë një masë disiplinore “vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra” me urdhrin nr. ***, datë 24.10.2012, të Prokurorisë së Përgjithshme. Kjo masë disiplinore konsiston në shkelje të shumta ligjore të kryera nga prokurori Olger Eminaj, të cilat lidhen me nxjerrjen me vonesë të urdhrave të ekzekutimit të një numri të konsiderueshëm të vendimeve penale të formës së prerë.
90. Nga verifikimi i kryer evidentohet se shkeljet e kryera nga subjekti i rivlerësimit kanë qenë objekt shqyrtimi nga Këshilli i Prokurorisë në mbledhjen e datës 16.10.2012, ku në përfundim anëtarët e Këshillit të Prokurorisë kanë dalë me mendim unanim për t’i propozuar Prokurorit të Përgjithshëm që ndaj prokurorit Olger Eminaj të jepet masa disiplinore “vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra”.
91. Nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave të prokurorive të rretheve gjyqësore nuk rezulton që ndaj subjektit të rivlerësimit Olger Eminaj të jenë regjistruar kallëzime apo procedime penale.
92. Nga të dhënat arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme është paraqitur një ankesë ndaj subjektit të rivlerësimit Olger Eminaj (praktika nr. ***, viti 2019) nga shtetasja A.Xh-F (të përsëritura), e cila pretendon për mosdhënie informacioni nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në lidhje me procedimin penal nr. ***, viti 2018.

93. Për këtë çështje ankuesja ka paraqitur edhe denoncim pranë Komisionit, e cila trajtohet në vijim të këtij vendimi, në seksionin “Denoncime”.
94. Për subjektin e rivlerësimit Olger Eminaj nuk ka të dhëna apo informacione për cenim të figurës apo të jetë përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, si dhe të dhëna për raste të identifikimit të subjektit të rivlerësimit për kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale).
95. Pranë Prokurorisë së Përgjithshme ka të dhëna për vlerësimin e punës së prokurorit Olger Eminaj, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, ku për vitet 2014 dhe 2015 subjekti Olger Eminaj është vlerësuar “mirë”, ndërsa për vitin 2016 është vlerësuar “shumë mirë”.

ANALIZA E GJETJEVE

96. Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

97. Aftësitë profesionale

97.1 Prokurori Olger Eminaj shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit në analizën e provave dhe arsyetimin ligjor e logjik. Nga dosjet e vëzhguara ai identifikon drejt normën ligjore të zbatueshme dhe argumenton arsyet për zbatimin e saj në rastin konkret. Në lidhje me zbatimin e ligjit material i kushton rëndësi analizës së elementeve të veprës penale për të konkluduar në kualifikimin ligjor të faktit penal.

98. Aftësitë organizative

98.1 Në analizë të të dhënave subjekti Olger Eminaj ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, ku i ka kryer hetimet si dhe drejtuar e kontrolluar veprimtarinë hetimore brenda një afati të arsyeshëm në raport me kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e çështjeve. Prokurori Olger Eminaj ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve dhe rregullsisë së akteve. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të sakta, të strukturuar.

99. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

99.1 Për periudhën objekt vlerësimi nuk rezulton të ketë pasur raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar prokurorit Olger Eminaj. Në asnjë prej dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

100. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

100.1 Subjekti i rivlerësimit Olger Eminaj në periudhën e vlerësimit ka shfaqur aftësi të mira komunikuese, duke shfaqur aftësi profesionale në diskutime teknike për çështje të ndryshme.

100.2 Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, për periudhën objekt vlerësimi subjekti Olger Eminaj nuk ka paraqitur të dhëna mbi angazhimin e tij në aktivitete profesionale.

DENONCIME

101. Për subjektin e rivlerësimit Olger Eminaj rezultojnë 7 denoncime nga publiku. Nga verifikimi i denoncimeve ka rezultuar se:

- i. Në dy denoncime janë ngritur pretendime për vendimmarrje të padrejtë, të cilat lidhen me themelin e çështjes dhe nuk janë objekt shqyrtimi nga ana e Komisioni, pasi shqyrtohen nga gjykatat më të larta.
- ii. Në tri denoncime janë ngritur pretendime për zvarritje dhe tejkalim të afateve hetimore, ndërsa në një denoncim pretendohet për hetim të kryer mbi prova të selektuara dhe dënim të padrejtë, të cilat janë analizuar nga Komisioni dhe gjenden të trajtuara në pikat 103 - 106, në vijim të këtij vendimi.
- iii. Në një denoncim të depozituar në datën 1.3.2023 janë ngritur pretendime për vonesa në kryerjen e hetimeve, të cilat kanë shkaktuar humbjen e fuqisë së paraburgimit dhe nxjerrjen nga burgu të të pandehurve për 6 çështje penale, të cilat u verifikuan nga Komisioni dhe do të trajtohen në vijim të këtij vendimi (pika 107, i-vi), nga ku ka rezultuar se:
 - Në 5 prej çështjeve penale subjekti ka kaluar afatet e hetimit duke shkaktuar humbjen e fuqisë së paraburgimit për të pandehurit (ku 3 prej tyre janë ende nën hetim), ndërsa për 1 çështje penale subjektit i janë kërkuar shpjegime mbi arsyet që çuan në miratimin e zëvendësimit të masës së sigurimit në një masë më të lehtë, pa u përmbushur kriteret ligjore.

102. Nga analizimi i denoncimeve nga Komisioni ka rezultuar si vijon:

103. Denoncim i shtetasit Z.S

103.1 Ky shtetas ka paraqitur ankim ndaj 3 subjekteve të rivlerësimit, midis të cilëve edhe prokurorin Olger Eminaj, me pretendimin se ky prokuror gjatë hetimit të çështjes së tij ka qenë i ndikuar nga ish-epropri i tij K.H dhe gjyqtari A.B, i cili ka lidhje farefisnore me një prej të kallëzuarve, ortak i shoqërisë së transportit. Gjithashtu, denoncuesi pretendon se prokurori Olger Eminaj dhe oficeri i policisë gjyqësore kanë shtrembëruar qëllimisht dinamikën e ngjarjes dhe provat, si dhe është sorollatur nga Prokuroria e Rrethit Korçë për plot 1 vit e 7 muaj.

103.2 Nga verifikimi i dosjes penale⁷⁰ Komisioni ka konstatuar vonesa⁷¹ në kryerjen e veprimeve hetimore nga subjekti.

103.3 Në lidhje me këtë konstatim subjektit iu kërkuar shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

103.4 Në prapësimet e datës 3.3.2023 subjekti ka parashtruar në mënyrë të detajuar rrethanat e çështjes penale, si dhe veprimet hetimore të kryera prej tij në kuadër të këtij procedimi penal, duke shpjeguar se denoncuesi pas vitit 2012 ka filluar të luajë në bursën e Stambollit, ku blinte flori dhe argjend me çmim të leverdishëm dhe e rishiste kur çmimi i mallit rritej. Në muajin shtator 2015 kallëzuesit i duhej një sasi e konsiderueshme të hollash për të luajtur në bursën e Stambollit dhe nisur nga fakti se transfertat me bankë kushtonte shumë për shkak të komisionit të lartë bankar, ai ka biseduar me drejtuesin e autobusit, i cili punonte për një agjenci udhëtimesh, si dhe një nga

⁷⁰ Dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 26.1.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

⁷¹ Subjekti nuk ka kryer veprime hetimore gjatë periudhave shkurt - qershor 2017 dhe gusht 2017 - janar 2018.

ortakët e agjencisë së udhëtimit duke i dhënë shumën prej 150.000 euro për t'ia çuar kallëzuesit në Stamboll, i cili do ta përdorte për blerje floriri.

103.5 Në autobusin ku transportoheshin paratë e kallëzuesit ka ndodhur një vjedhje gjatë qëndrimit për një pushim 30 minuta, në një karburant të një qyteti të Greqisë, nga një person i paidentifikuar, ku shoferi i autobusit ka konstatuar vjedhjen e shumës së eurove.

103.6 Ndër të tjera, subjekti ka shpjeguar se nisur nga fakti se ngjarja e vjedhjes ka ndodhur në shtetin grek, në kuadër të veprimeve hetimore ka dërguar letërporosi në shtetin grek në lidhje me procedimin e nisur nga autoritetet e këtij shteti për vjedhjen e ndodhur, por përgjigjja e letërporosisë ka mbërritur jo e plotë dhe, për këtë arsye, subjekti ka përpiluar një tjetër letërporosi.

103.7 Sipas subjektit, me qëllim verifikimin e pretendimeve të kallëzuesit se gjithçka që kishte ndodhur nuk ishte një vjedhje e rastësishme, por diçka e paramenduar dhe planifikuar mirë, janë kryer hetime lidhur me drejtuesin e autobusit dhe shoqërinë e transportit, e cila kishte në pronësi autobusin. Sipas subjektit, të gjitha këto veprime janë kryer në kuadër të procedimit penal nr. ***, viti 2016, i cili është regjistruar për veprat penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/3 i Kodit Penal dhe “mosdeklarim në kufi i të hollave dhe sendeve me vlerë”, parashikuar nga neni 179/a i Kodit Penal, ku për veprën penale të parashikuar nga neni 179/a i Kodit Penal është vendosur pushimi i çështjes për shkak të amnistisë, ndërsa për veprën tjetër penale të parashikuar nga neni 134/3 i Kodit Penal është vendosur pezullimi i hetimeve, pasi autori/autorët e veprës penale nuk njiheshin. Më tej, subjekti ka shpjeguar se ndodhur përballë kërkesave të vazhdueshme të kallëzuesit/viktimit të veprës penale, i cili ngrinte dyshime për paanësinë e subjektit, ai ka dhënë dorëheqjen dhe çështja është hetuar nga një prokuror tjetër, i cili gjithashtu ka vendosur pezullimin e saj.

103.8 Lidhur me konstatimet e Komisionit për vonesa në kryerjen e veprimeve hetimore në periodat shkurt - qershor 2017 dhe gusht 2017 - janar 2018, subjekti ka prapësuar se në muajt e parë pas regjistrimit të procedimit penal janë kryer një sërë veprimesh hetimore, nisur nga vlera e madhe e deklaruar e vjedhur nga kallëzuesi/viktima e veprës penale dhe për rastin në fjalë është kërkuar ndihmë juridike nga shteti grek në kuadër të një hetimi të plotë shterues.

103.9 Subjekti ka depozituar⁷² si dokumentacion provues aktet e letërporosive drejtuar shtetit grek, duke shpjeguar se vonesat e konstatuara nga Komisioni kanë ndodhur për shkak të pritjes së përgjigjes së letërporosive dërguar shtetit grek. Konkretisht, në datën 20.6.2017 është përpiluar dhe dërguar kërkesa për ndihmë gjyqësore ndërkombëtare në lëndë penale autoriteteve greke të drejtësisë dhe përgjigjja e këtyre autoriteteve ka mbërritur në Prokurorinë e Rrethit Korçë më 29.1.2018 dhe menjëherë aktet janë përcjellë në Ministrinë e Drejtësisë për përkthim (datë 29.1.2018). Pra, për periudhën kohore gusht 2017 - janar 2018 nuk janë kryer veprime hetimore, pasi është pritur përgjigjja e letërporosive nga autoritetet greke dhe veprimet hetimore janë gjykuar të nevojshme për rastin konkret.

⁷² (1) Shkresë nr. *** prot., datë 20.6.2016, kërkesë për ndihmë gjyqësore ndërkombëtare në lëndë penale, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Juridiksionale, drejtuar Autoritetit Gjyqësor Kompetent Greqi, për dijeni Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë (viti i shkresës duket se ka një lapsus, pasi i përket vitit 2017); (2) shkresë nr. *** prot., datë 25.1.2018, e Ministrisë së Drejtësisë drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; (3) shkresë nr.***prot., date 30.1.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila dërgon aktet procedurale për përkthim te Ministria e Drejtësisë.

Vlerësimi i Komisionit

103.10 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe akteve në dosjen penale, vëren se subjekti në përmbushje të detyrave të tij funksionale ka ndërmarrë një sërë veprimesh hetimore nga momenti i regjistrimit të procedimit penal në datën 21.10.2016 deri në janar të vitit 2017, e ndërsa në vijim, gjatë periudhës shkurt - qershor 2017 nuk evidentohen veprime hetimore të kryera. Komisioni konstaton se subjekti nuk ka dhënë shpjegime sa i përket zvarritjes së hetimeve për periudhën rreth 4 muaj deri në qershor 2017, kur në këtë muaj është dërguar letërporosia, drejtuar autoriteteve greke, veprim i cili mund të ishte kryer edhe më herët nga ana e subjektit.

103.11 Megjithatë, trupi gjykues çmon të marrë në konsideratë edhe faktorë të tjerë referuar shpjegimeve të subjektit, që lidhen kryesisht me dinamikën e ngjarjes dhe kompleksitetin e kësaj çështjeje penale, nisur nga fakti që vepra penale e vjedhjes ka ndodhur në shtetin grek, të cilat në mënyrë indirekte mund të kenë ndikuar në ecurinë e veprimeve hetimore dhe vonesat e hetimit. Për sa i përket periudhës së pritjes së letërporosisë nga autoritetet e huaja, e cila nuk varet nga veprimet e prokurorit, Komisioni e konsideron të justifikuar këtë periudhë kohore, duke e vlerësuar të rëndësishme përgjigjen e autoriteteve të huaja me efekt ndikues në zgjidhjen e çështjes penale.

104. Denoncim i shtetasit A.B

104.1 Në denoncimin e tij, ky shtetas ka pretenduar se 4 prokurorë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, ndërmjet të cilëve edhe prokurori Olger Eminaj, kanë treguar njëanshmëri në veprimet e tyre si prokurorë, në shkelje flagrante të ligjit, si dhe me zvarritje të pajustificueshme tej çdo afati ligjor, lidhur me çështjen penale nr. ***, datë 2.3.2018, të regjistruar për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” ku, si pasojë, ka gjetur vdekjen shtetasi B.B (djali i denoncuesit).

104.2 Denoncuesi jep detaje mbi rrethanat e ndodhjes së aksidentit, në të cilin djali i tij humbi jetën. Ky aksident ka ndodhur në datën 30.5.2017, në segmentin rrugor Korçë - Ersekë, ku automjeti me të cilin po udhëtonte djali i tij u përplas me automjetin e një shtetasi francez, të dy punonjës të shoqërisë “T.S”. Denoncuesi pretendon se prokurori Olger Eminaj nuk e ka njoftuar për ecurinë e çështjes në zbatim të detyrave të lëna nga gjykata (të cilat duhet të përfundonin brenda datës 12.7.2019).

Konstatime të Komisionit

104.3 Nga verifikimi i akteve të dosjes penale Komisioni ka konstatuar se:

- Subjekti i rivlerësimit ka tejkalluar afatet e hetimeve të përcaktuara në dy vendimet⁷³ gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë duke zvarritur hetimin.

⁷³ 1) Referuar vendimit nr. *** sp, datë 29.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë nr. **, datë 17.7.2018, është vendosur kthimi i akteve dhe vazhdimi i hetimeve për një afat 2-mujor nga marrja e vendimit të formës së prerë. Afati i përfundimit të hetimeve bazuar në vendimin gjyqësor dhe vendimin e Drejtuesit të Prokurorisë për zgjatjen e afatit të hetimit ishte përcaktuar deri në datën 17.11.2018, ndërsa hetimet kanë zgjatur deri në janar të vitit 2019; (2) referuar vendimit nr. ***, datë 27.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë (marrë formë të prerë në datën 12.4.2019) është vendosur kthimi i akteve dhe vazhdimi i hetimeve brenda një afati 3-mujor nga marrja e vendimit të formës së prerë, ndërsa hetimet kanë zgjatur deri më 20.10.2020 (periudhë kur është kryer zëvendësimi i prokurorit Olger Eminaj).

- Subjekti nuk ka disponuar me vendim ndaj kërkesë-memories datë 26.5.2020, të paraqitur nga trashëgimtari i viktimës, sipas përcaktimeve të nenit 110⁷⁴ të Kodit të Procedurës Penale.

104.4 Në lidhje me këto konstatime subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

104.5 Përmes prapësimeve të depozituara në datën 3.3.2023 subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se për këtë çështje është vendosur mosfillimi i procedimit penal, vendim i cili pas ankesës së denoncuesit (babai i viktimës) është prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr. ***, datë 2.11.2017, e cila ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal dhe vazhdimin e hetimeve. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 8.2.2018. Subjekti ka shpjeguar se me hetimin e kësaj çështjeje penale është ngarkuar një tjetër prokuror, i ndryshëm nga prokurori që disponoi vendimin e mosfillimit dhe pas kryerjes së veprimeve hetimore prokurori i çështjes ka arritur në konkluzionin se çështja penale duhet të pushohet. Subjekti thekson faktin se si vendimi i mosfillimit i shfuqizuar nga gjykata, po ashtu edhe kërkesa e parë për pushimin e çështjes janë përpiluar nga prokurorë të tjerë dhe momenti kur subjekti është ngarkuar për vazhdimin e hetimeve të kësaj çështjeje është pas vendimit gjyqësor nr. *** (sp), datë 29.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila ka vendosur kthimin e akteve për vazhdimin e hetimeve.

104.6 Subjekti ka prapësuar se në kuadër të hetimit ka kryer një sërë veprimesh procedurale dhe në përfundim ka gjykuar se procedimi duhet të pushohet, pasi fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale. Kjo çështje penale është gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila me vendimin nr. ***, datë 27.3.2019, ka vendosur mospranimin e kërkesës së prokurorit dhe kthimin e akteve për vazhdimin e hetimeve për një afat 3 muaj. Subjekti ka argumentuar se ky vendim nuk është ankimuar nga ana e tij si prokuror, pasi ka vlerësuar se detyrat e lëna nga gjykata ishin veprime procedurale hetimore shteruese dhe do u jepnin përgjigje trashëgimtarëve të viktimës.

104.7 Subjekti e vlerëson të drejtë konstatimin e Komisionit për mosrespektimin e afatit 3-mujor të hetimeve sipas vendimit të gjykatës, për të cilën ka shpjeguar se arsyet e mosrespektimit të këtij afati kanë pasur të bëjnë me numrin e madh të veprimeve hetimore të kryera për këtë çështje. Subjekti ka argumentuar se kryerja e veprimeve hetimore tej afatit të përcaktuar nga gjykata nuk passjell pavlefshmërinë apo papërdorshmërinë e këtyre veprimeve.

104.8 Sa i përket konstatimit të Komisionit, në lidhje me mosdisponimin me vendim ndaj kërkesë-memories datë 26.5.2020, të paraqitur nga trashëgimtari i viktimës, subjekti ka shpjeguar se ky shtetas dhe përfaqësuesi i tij ligjor kanë bërë mbi 10 kërkesa drejtuar Prokurorisë së Rrethit Korçë dhe institucioneve të tjera, ku shumica e tyre kishte përmbajtje të njëjtë dhe subjekti i ka kthyer përgjigje brenda afateve ligjore. Gjithashtu, përveç kërkesave zyrtare, denoncuesi është sqaruar edhe verbalisht nga subjekti. Subjekti ka prapësuar se mosdisponimi me vendim ndaj kësaj kërkesë-memorieje, datë 26.5.2020, ka ndodhur për shkak të ngarkesës në punë dhe përsëritjes së kërkesave të njëjta. Sipas subjektit, palës kërkuese i është kthyer përgjigje për këtë çështje më

⁷⁴ Neni 110 i Kodit të Procedurës Penale, memoriet dhe kërkesat e palëve: “Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim. Organi procedues shprehet me vendim brenda 15 ditësh”.

shumë se çdo çështjeje të hetuar prej tij. Subjekti ka depozituar⁷⁵ dokumentacion për të provuar veprimet hetimore, si dhe përgjigjet e kthjera ndaj kërkesë-memorieve të paraqitura nga trashëgimtari i viktimës. Subjekti ka shpjeguar se pas kërkesave të përsëritura, denoncuesi për zëvendësimin e prokurorit, ka gjykuar dhënien e dorëheqjes nga kjo çështje, për hetimin e së cilës janë ngarkuar dy prokurorë të tjerë (njeri pas tjetrit) dhe i fundit prej tyre e ka ende në hetim çështjen.

Vlerësimi i Komisionit

104.9 Referuar shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me tejkalimin e afateve, si dhe nga analizimi i akteve të dosjes penale, Komisioni vlerëson se nga ana e subjektit janë kryer një sërë veprimesh hetimore, të cilat justifikojnë mosrespektimin e afateve të hetimit dhe, për rrjedhojë, nuk mund të klasifikohen si mangësi profesionale.

104.10 Sa i përket mosdisponimit me vendim ndaj kërkesë-memories datë 26.5.2020, të paraqitur nga trashëgimtari i viktimës, Komisioni i vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit, pasi nga aktet në dosjen penale rezulton se trashëgimtari i viktimës ka marrë përgjigje për çdo kërkesë-memorie të paraqitur prej tij, përjashtuar kërkesën e datës 26.5.2020, të evidentuar nga Komisioni. Në këtë drejtim, trupit gjykues nuk i rezultuan *indicie* apo elemente në çështje të tjera për të ngritur dyshime se subjekti ka një mënyrë/model pune të papajtueshëm me pozicionin e tij apo ndonjë shkelje e respektimit të të drejtave të palëve. Për rrjedhojë, nuk mund të marri peshë në vlerësimin përfundimtar të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

105. Denoncime të përsëritura⁷⁶ nga shtetasi V.N

105.1 Ky shtetas ka paraqitur 13 denoncime ndaj disa prokurorëve, gjyqtarëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, midis të cilëve është edhe prokurori Olger Eminaj, për të cilin pretendon për zvarritje të hetimit, korrupsion dhe shkelje të etikës profesionale. Denoncuesi i referohet një çështjeje penale të hetuar ndaj tij për veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, bazuar në kallëzimin e shtetases E.Q, datë 2.10.2015. Sipas denoncuesit, prokurori Olger Eminaj nuk ka hetuar çështjen mbi dokumentet themelore të këtij procesi penal,

⁷⁵ (1) Urdhër për delegimin dhe kryerjen e veprimeve hetimore datë 27.9.2018; (2) kërkesë - memorie datë 1.10.2018 dhe shkresa kthim përgjigje nr. *** prot., datë 31.10.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, bashkëlidhur vendimi datë 24.10.2018 për shqyrtimin e kërkesës me shkrim të trashëgimtarit të viktimës nga vepra penale; (3) shkresa nr. *** prot., datë 12.11.2018, kthim përgjigjeje nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; (4) shkresa nr. *** prot., datë 4.12.2018, Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; (5) kërkesë memorie e paraqitur nga trashëgimtari i viktimës (protokolluar me nr. ***-K, datë 28.6.2019, me shënimin për prokurorin Olger Eminaj datë 1.7.2019), shkresa nr. *** prot., datë 16.7.2019, kthim përgjigjeje nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe vendimi për shqyrtimin e kërkesës me shkrim të trashëgimtarit të viktimës nga vepra penale; (6) kërkesë nr. ** prot., datë 8.7.2019, e trashëgimtarit të viktimës A.B dhe shkresa nr. *** prot., datë 16.7.2019, kthim përgjigjeje e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; (7) kërkesë memorie nr. *** prot., datë 11.5.2020, e trashëgimtarit të viktimës A.B (ku kërkuesi ka shënuar me shkrim dore që ka marrë përgjigje për sa kërkohet); (8) kërkesë nr. *** prot., datë 18.6.2020, e trashëgimtarit të viktimës A.B dhe shkresa nr. *** prot., datë 26.6.2020, kthim përgjigjeje e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; (9) kërkesë e av. E.S, drejtuar prokurorit Olger Eminaj (protokolluar me nr. ***-K) datë 14.7.2020 dhe shkresa nr. *** prot., datë 17.7.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

⁷⁶ (1) Denoncimi nr. *** prot., datë 27.12.2018; (2) denoncimi nr. *** prot., datë 27.12.2018; (3) denoncimi nr. *** prot., datë 13.5.2019; (4) denoncimi nr. *** prot., datë 5.7.2019; (5) denoncimi nr. *** prot., datë 9.9.2019; (6) denoncimi nr. *** prot., datë 9.9.2019; (7) denoncimi nr. *** prot., datë 25.9.2019, i adresuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit; (8) denoncimi nr. ** prot., datë 8.1.2020; (9) denoncimi nr. *** prot., datë 26.5.2020; (10) denoncimi nr. *** prot., datë 27.5.2020; (11) denoncimi nr. *** prot., datë 13.1.2020, e adresuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit; (12) denoncimi nr. *** prot., datë 16.1.2020, e adresuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit; (13) denoncimi nr. *** prot., datë 15.1.2020, e adresuar nga Institucioni i Komisionerit Publik.

por ka hetuar mbi prova të selektuara, të grumbulluara nga ata vetë, duke ndryshuar themelin e hetimit dhe duke e dënuar padrejtësisht denoncuesin.

105.2 Nga verifikimi i dosjes penale të administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë⁷⁷ ka rezultuar se prokurori Olger Eminaj, në datën 4.2.2016, ka paraqitur kërkesën për gjykimin e çështjes penale në gjykatë për të pandehurin/denoncuesin V.N, për veprën penale “shpërdorim detyre”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

105.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, në datën 19.9.2016, ka vendosur deklarinimin fajtor të z. V.N dhe dënimin e tij me 4 muaj burg, si dhe heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike për një periudhë 1-vjeçare, vendim i cili është prishur nga Gjykata e Apelit Korçë, e cila me vendimin nr. **, datë 1.3.2017, ka vendosur pushimin e çështjes penale, pasi, sipas kësaj gjykate, çështja duhet të mbyllet si shkelje administrative, një qëndrim i kundërt me atë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

105.4 Ndaj këtij vendimi, në datën 30.3.2017, ka ushtruar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë, çështje e cila është në proces studimi pranë Gjykatës së Lartë.

105.5 Lidhur me pretendimet e denoncuesit, subjektit iu kërkuan shpjegime bazuar në dokumentacionin mbështetës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

105.6 Subjekti i rivlerësimit, përmes prapësimeve të datës 3.3.2023, ka shpjeguar se ky shtetas është marrë i pandehur prej tij, si autor i veprës penale “shpërdorim detyre”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Subjekti ka parashtruar në mënyrë të detajuar rrethanat e çështjes penale, si dhe ka analizuar elementet e veprës penale “shpërdorim detyre”, duke shpjeguar se kjo veprë penale kërkon plotësimin e disa kushteve në mënyrë që të ketë përgjegjësi sipas kësaj dispozite lidhur me veprime apo mosveprime të kryera me dashje nga një person i ngarkuar me funksion publik në kundërshtim me ligjin dhe, që, si pasojë e tyre të jenë dëmtuar interesat e shtetit apo shtetasve.

105.7 Sipas subjektit, në vendimin datë 1.3.2017 të Gjykatës së Apelit Korçë, e cila ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë datë 19.9.2019 dhe pushimin e çështjes penale, ndër të tjera, arsyetohet se shkelja e konstatuar në rastin konkret është një shkelje administrative dhe nuk përfshihet në sferën e veprimit të nenit 248 të Kodit Penal. Subjekti ka prapësuar se ndryshe nga sa thuhet në këtë vendim, është ende i bindur se në rastin konkret ka të bëjë me shkelje të nenit 105/2 të Kodit të Punës, e cila është një dispozitë urdhëruese dhe, për rrjedhojë, ka konsumim të veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, me pasojë mospagesën e kallëzueses nga sigurimet shoqërore.

105.8 Subjekti ka prapësuar se fakti bëhet më evident në momentin kur shtetasi V.N, në cilësinë e drejtorit të shkollës, është bërë me dije nga tri institucione, Drejtoria Arsimore Korçë, Avokati i Popullit dhe Ministria e Arsimit, që ishte duke vepruar në kundërshtim me ligjin. Subjekti ka argumentuar se ky vendim i tij është miratuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, ku kjo çështje aktualisht është në gjykim në Gjykatë të Lartë. Gjithashtu, për rastin në fjalë, ky shtetas ka

⁷⁷ Dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 26.1.2023.

paraqitur edhe ankim në ILD dhe ky institucion ka marrë vendimin për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës.

Vlerësimi i Komisionit

105.9 Trupi gjykues argumenton se vendimmarrja e prokurorit diktohet nga bindja e tij e brendshme, e cila lidhet me interpretimin e ligjit në kontekstin e fakteve dhe provave të çështjes penale. Në këtë rast, trupi gjykues mban në konsideratë parashikimin ligjor të nenit 73/4 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku në referim të kësaj dispozite vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit, pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

105.10 Lidhur me pretendimet e tjera të denoncuesit të cilat vinin të pashoqëruara me ndonjë provë apo dokumentacion mbështetës sipas kërkesave të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni çmon të mos i marrë në konsideratë.

105.11 Në vlerësimin final lidhur me këtë çështje, trupit gjykues nuk i rezultuan *indicie* apo rrethana për fakte konkrete, të cilat të krijojnë bindjen se subjekti ka kryer shkelje ligjore në veprimtarinë e tij, në cilësinë e prokurorit të çështjes.

106. Denoncime të shtetases A.Xh⁷⁸

106.1 Kjo shtetase ka paraqitur 6 denoncime ndaj subjektit të rivlerësimit Olger Eminaj, me pretendimin se ky prokuror ka konsumuar veprën penale “shpërdorim detyre”, për shkak të mosushtrimit të detyrës sipas ligjit dhe mosdhënies së informacionit për çështjen penale. Denoncuesja pretendon për zvarritje të hetimit, si dhe mosnjohim për zgjatjen e afatit të hetimeve, pasi kanë kaluar rreth 3 vjet dhe ende nuk ka informacion për fatin e kallëzimit të saj.

106.2 Komisioni ka kërkuar kopje të fashikullit të dosjes penale, e cila në datën 24.4.2018 i ka kaluar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Kjo Prokurori ka informuar⁷⁹ se çështja penale është ende nën hetim.

106.3 Lidhur me zvarritjen e hetimit të pretenduar nga denoncuesja subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

106.4 Subjekti përmes prapësimeve të depozituara në datën 3.3.2023 ka shpjeguar se kjo çështje penale është duke u hetuar prej tij, ku që prej momentit të regjistrimit të këtij procedimi penal nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë janë kryer një sërë veprimesh procedurale.

106.5 Për të provuar këtë fakt, subjekti ka depozituar dy urdhra të datave 1.12.2020 dhe 11.2.2021, përmes të cilëve ka urdhëruar oficerin e policisë gjyqësore për kryerjen e një sërë veprimesh hetimore. Subjekti ka shpjeguar se ky procedim penal është në përfundim dhe kallëzuesja do të njoftohet së shpejti në lidhje me përfundimin e hetimeve dhe mënyrën e zgjidhjes. Sipas subjektit, vonesat në hetim kanë ardhur si pasojë e ngarkesës në punë.

⁷⁸ (1) Denoncimi nr. *** prot., datë 5.12.2018; (2) denoncimi nr. *** prot., datë 24.1.2019; (3) denoncimi nr. *** prot., datë 3.9.2019; (4) denoncimi nr. *** prot., datë 22.11.2021; (5) denoncimi nr. *** prot., datë 23.11.2021, i adresuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit; (6) denoncimi nr. *** prot., datë 18.2.2019, i adresuar nga Institucioni i Komisionerit Publik.

⁷⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 26.1.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Vlerësimi i Komisionit

106.6 Trupi gjykues, në vlerësim të situatës faktike dhe shpjegimeve të subjektit, çmon se shkaqet që mund të kenë çuar në zvarritjen e hetimeve janë të lidhura me veprime konkrete hetimore të ndërmarra nga ana e subjektit të rivlerësimit, si dhe kompleksitetin e çështjes, të cilat nuk mund të verifikohen dhe të jenë objekt rivlerësimi nga Komisioni, nisur nga fakti se çështja penale është ende nën hetim.

106.7 Për rrjedhojë, trupi gjykues ndodhet në kushtet e pengesës⁸⁰ ligjore për vlerësimin e subjektit, të parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës parashikohet se: *“Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim”*.

106.8 Përfundimisht, trupi gjykues vlerëson se kontrolli i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit për këtë çështje penale nuk mund të kryhet nga Komisioni, pasi do të përbënte tejkalim të kompetencës kushtetuese.

107. Denoncim datë 1.3.2023 i shtetases F.M

107.1 Denoncuesi pretendon se prokurori Olger Eminaj ka kryer shkelje të rënda procedurale, duke favorizuar kriminelë dhe përsëritës të rrezikshëm, ku janë të shumta rastet e ngjashme ku ky prokuror, në shkelje të ligjit dhe procedurës, në pamje të parë duket sikur lufton krimin, arreston personat për vepra të rënda dhe më pas i liron, pasi harron afatet e paraburgimit. Denoncuesi ka referuar 6 prej çështjeve penale me emra të pandehurish dhe veprimet e paligjshme të prokurorit, të kryera për secilën nga çështjet penale.

107.2 Komisioni ka kërkuar dosjet përkatëse penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë⁸¹, e cila ka dërguar vetëm 3 prej fashikujve të procedimeve penale, pasi 3 dosjet e tjera ishin ende në proces hetimi. Gjithashtu janë administruar edhe vendimet gjyqësore të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë⁸² për secilën nga këto çështje, ku nga verifikimi i kryer ka rezultuar si vijon:

i. Çështja penale nr. * me të pandehur S.V dhe V.C**, të akuzuar për veprën penale “trafikim i narkotikëve” e kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, e parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal dhe neni 22 i Kodit Penal. Kjo çështje penale është ende në hetim.

Referuar vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, datë 25.3.2022⁸³, për të pandehurin S.V është vendosur konstatimi i humbjes së fuqisë së paraburgimit për shkak të kalimit të afatit më shumë se 12 muaj dhe caktimi i masës së sigurimit “arrest në shtëpi”.

Gjithashtu edhe për të pandehurin V.C, Gjykata e Apelit Korçë në datën 24.3.2022 ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, datë 10.2.2022, duke konstatuar humbjen e fuqisë së paraburgimit dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”.

107.3 Nga aktet në dosje është konstatuar se subjekti nuk ka kryer veprimet e duhura hetimore dhe nuk ka paraqitur kërkesë për zgjatje të afatit të paraburgimit, pas kthimit të akteve nga gjykata, për

⁸⁰ Referuar edhe qëndrimin të mbajtur nga Kolegji në vendimin nr. 33, datë 3.11.2021 (subjekti N.T).

⁸¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 10.3.2023.

⁸² Me shkresën nr. *** prot., datë 3.3.2023.

⁸³ Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 4.4.2022.

rrjedhojë kanë kaluar afatet e hetimit, duke shkaktuar humbjen e fuqisë së paraburgimit në vështrim të nenit 263/1 të Kodit të Procedurës Penale.

107.4 Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime mbi arsyet që kanë shkaktuar vonesën e hetimit, e cila ka passjellë humbjen e fuqisë së paraburgimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

107.5 Subjekti i rivlerësimit, përmes prapësimeve të paraqitura në datën 24.3.2023, ka shpjeguar se kjo dosje voluminoze është hetuar fillimisht nga dy prokurorë të tjerë. Subjekti ka shpjeguar se pas hetimeve të kryera nga prokurori G.S. në janar 2021 ka vendosur dërgimin për gjykim të të pandehurve S.V dhe V.C dhe gjatë gjykimit në seancën paraprake gjykata ka vendosur kthimin e akteve prokurorit me qëllim plotësimin e hetimeve. Në qershor të vitit 2021, ky prokuror është larguar me vendim të Komisionit dhe çështja i kaloi prokurorit E. Sh. Pas plotësimit të hetimeve dhe dërgimit të tyre në gjykatë, kjo e fundit ka vendosur kthimin e akteve prokurorit. Pas kthimit të akteve, vendimmarrje kjo e muajit shtator 2021, prokurori E. Sh. në nëntor të vitit 2021 ka dhënë dorëheqjen, me arsyetimin se hetimi i saj i përkiste Seksionit të Posaçëm në Prokurorinë Korçë, pjesë e të cilit ishte edhe subjekti. Subjekti ka shpjeguar se ky është momenti kur është ngarkuar me hetimin e kësaj çështjeje (nëntor 2021) dhe deri në konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit kishin kaluar rreth 4 muaj. Më tej, subjekti ka parashtruar se arsyeja e humbjes së fuqisë së paraburgimit për dy të pandehurit duhet të merret në kontekstin e organikës dhe numrit të prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila ka në total në organikë 13 prokurorë, ku ushtrojnë funksionin e tyre vetëm 9 prokurorë, numri i të cilëve është reduktuar në 7, për shkak të largimit të tyre, dorëheqjeve apo transferimit në prokurori të tjera.

107.6 Subjekti ka shpjeguar se hetimi i kësaj çështjeje edhe nga dy prokurorë të tjerë nga ana praktike sjell vështirësi më të madhe në llogaritjen e afateve të paraburgimit për shtetasin nën hetim apo të pandehur, dhe në këtë periudhë kohore ka pasur në hetim disa procedime (3 prej të cilave janë administruar nga Komisioni), ku nën hetim ishin një numër i madh personash dhe fashikujt e tyre kanë qenë me disa volume, shumë prej të cilave kanë pasur afate të ngutshme (zgjatje afati përgjimi apo kërkesa për lejim përgjimi, vendime sekuestrimi, vleftësim kontrollesh etj., si dhe pjesëmarrja në gjykime). Në përfundim, subjekti sqaroi se ka qenë gati i pamundur përfundimi i hetimeve në kohën e duhur, duke argumentuar se vetë fakti që gjykata e ka kthyer këtë çështje dy herë për plotësim hetimesh tregon kompleksitetin e hetimeve.

Vlerësimi i Komisionit

107.7 Në vlerësim të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit mbi shkaqet që kanë çuar në zgjatjen e veprimeve hetimore dhe, për pasojë, në humbjen e fuqisë së paraburgimit, Komisioni ka argumentuar se:

- a. Vonesa në hetim nuk ka ardhur si pasojë e veprimeve të vetme dhe të drejtpërdrejta të subjektit të rivlerësimit, pasi kjo dosje penale ka qenë fillimisht nën hetim nga prokurorë të tjerë, dhe kalimi i afateve procedurale nuk mund të jetë përgjegjësi e vetme e subjektit të rivlerësimit.
- b. Gjithashtu, një faktor ndikues është edhe ngarkesa e lartë në punë, e pretenduar nga subjekti për shkak të organikës së reduktuar.

c. Nisur nga fakti se kjo çështje penale është ende duke u hetuar nga prokurori Olger Eminaj.

107.8 Nisur nga kjo e fundit, Komisioni ka konkluduar se ndodhet në kushtet e pengesës ligjore për vlerësimin e subjektit, edhe në këtë rast bazuar në parashikimin e nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

ii. Çështja penale nr. * me të pandehur I.M,** i akuzuar për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal. Bazuar në kërkesën e të pandehurit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin datë 20.10.2022 ka konstatuar humbjen e fuqisë së paraburgimit, pasi kanë kaluar 6 muaj dhe 1 ditë dhe nuk janë dorëzuar aktet në gjykatë, duke caktuar masën e sigurimit “arrest në shtëpi”. Kjo çështje penale është ende në hetim.

107.9 Nga hetimi i kryer është konstatuar se subjekti nuk ka përfunduar hetimet brenda afatit 6-mujor dhe nuk ka paraqitur kërkesë për zgjatje të afatit të paraburgimit, duke shkaktuar humbjen e fuqisë së paraburgimit, në vështrim të nenit 263/1/c të Kodit të Procedurës Penale.

107.10 Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime mbi arsyet që kanë shkaktuar vonesën e hetimit, e cila ka passjellë humbjen e fuqisë së paraburgimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

107.11 Subjekti ka shpjeguar rrethanat e kësaj çështjeje penale, e cila është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në shkurt të vitit 2022. Sipas subjektit, pas regjistrimit të procedimit me metoda proaktive të hetimit (përgjime telefonike, vëzhgime në ambiente publike, sekuestime të dozave të dyshuara narkotike etj.), është bërë e mundur të mblidhen prova, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm se shtetasi I.M kryente veprimtari të paligjshme në fushën e shitjes së lëndëve narkotike. Këtij shtetasi i është dokumentuar me prova shitja e një sasi lëndë narkotike prej 0.2 g tek një shtetas përdorues i këtyre lëndëve, vepër e cila, referuar nenit 283/1 të Kodit Penal, parashikon një dënim me burgim me marzh nga 5 deri në 10 vjet burgim.

107.12 Subjekti e konsideron të drejtë konstatimin e Komisionit, se për rastin në fjalë nuk është respektuar afati 6-mujor i paraburgimit, duke prapësuar se në kuadër të vlerësimit të pasojave të shkaktuara nga humbja e fuqisë së paraburgimit nga ana e Komisionit të merret në konsideratë fakti se për procedime të ngjashme (p.sh. procedimi penal nr. ***, viti 2019, me 7 të pandehur të cilin Komisioni e ka administruar) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykata e Apelit kanë zëvendësuar masën e sigurimit nga “arrest me burg” në masa më të lehta. Po ashtu, ky shtetas nuk është kapur me sasi të madhe lëndë narkotike, siç pretendohet nga denoncuesi, por dyshimi i arsyeshëm për përcaktimin e masës së sigurimit është krijuar nga dokumenti i shitjes së lëndës narkotike prej 0.2 g.

107.13 Subjekti ka prapësuar se ky procedim penal është ende nën hetim, me qëllim dokumentimin e aktivitetit të paligjshëm të shitjes së lëndës narkotike nga subjekte të tjera dhe ky procedim si dhe të tjera po hetohet me hetime proaktive, gjë që kërkon kohë të konsiderueshme.

Vlerësimi i Komisionit

107.14 Nisur nga fakti që kjo çështje rezulton të jetë ende nën hetim, në zbatim të pengesës ligjore të parashikuar në pikën 2, neni E i Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet se vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, si dhe orientimeve të Kolegjit⁸⁴, trupi gjykues çmon se kjo çështje nuk mund të vlerësohet nga Komisioni.

iii. Çështja penale nr. * ndaj të pandehurit Xh. R dhe të tjerë**, të akuzuar për veprën penale “ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal, çështje e cila është në gjykim.

107.15 Bazuar në kërkesën e tre të pandehurve E.L, M.G dhe Xh.R, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin datë 29.10.2022, ka konstatuar humbjen e fuqisë së masës së sigurimit⁸⁵ personal “arrest në shtëpi”, për shkak të kalimit të afatit hetimor mbi 6 muaj dhe mosdorëzimit të akteve në gjykatë, si dhe caktimin e masës së sigurimit “ndalim i daljes jashtë shtetit”, e parashikuar nga neni 233 i Kodit të Procedurës Penale.

107.16 Nga aktet e dosjes penale evidentohet se subjekti ka disponuar me vendim për zgjatjen e afateve të hetimit në datat 30.12.2021, 30.3.2022 dhe 30.6.2022, me qëllim kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, ndërkohë në dosjen penale nuk evidentohen veprime konkrete të kryera nga subjekti për të cilat është vendosur zgjatja e afateve hetimore. Gjithashtu, në datën 28.12.2022 subjekti ka vendosur ndarjen e çështjes penale në dy procedime penale, përkatësisht nr. ***, viti 2020 (për veprën penale të parashikuar në nenin 298/3 të Kodit Penal) dhe nr. ***, viti 2020, për të njëjtën vepër penale.

107.17 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se:

- Subjekti nuk ka përfunduar hetimet brenda afatit 6-mujor, duke shkaktuar humbjen e fuqisë së masës së sigurimit.
- Nga dosja penale nuk evidentohen veprime konkrete të kryera nga subjekti, për të cilat është vendosur zgjatja e afateve hetimore.
- Duket se ndarja e çështjes penale në dy procedime, në mbarim të afatit hetimor, është kryer për të favorizuar shtetasit nën hetim.

107.18 Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

107.19 Subjekti, përmes prapësimeve të paraqitura në datën 24.3.2023, ka shpjeguar se ky procedim penal është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, si pasojë e shpalljes së moskompetencës nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, pasi nga hetimet e kryera është konstatuar se personat e dyshuar për veprimtari kriminale ishin me vendbanim në Korçë.

⁸⁴ Vendimi nr. 33, datë 3.11.2021 (rasti N.T), i Kolegjit.

⁸⁵ Referuar nenit 237 të Kodit të Procedurës Penale, përcaktohet se: “...4. Për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi vlejné rregullat e caktuara për paraburgim”.

107.20 Subjekti ka shpjeguar se në dosjen penale të administruar nga Komisioni (e përbërë nga 3 fashikuj) nuk janë të përfshira aktet e ardhura nga Prokuroria e Rrethit Gjyrokastër dhe akte të tjera nga Prokuroria e Rrethit Korçë, pasi shtetasit e arrestuar dhe për të cilët u ngrit akuza kanë dalë gjatë hetimit proaktivë dhe nuk kanë qenë të njëjtë me shtetasit e dyshuar që në fillim të hetimeve. Mospërfshirja në dosjen e gjykatës e akteve të tjera ka pasur për qëllim ruajtjen e sekretit hetimor për hetimet që do të vazhdonin më pas për të dyshuarit e tjerë.

107.21 Subjekti ka shpjeguar se, duke qenë se edhe në këtë rast hetimi ishte kompleks, ku në faza të ndryshme të tij rezultonin njëri pas tjetrit persona të tjerë të dyshuar, është nevojitur një kohë më e gjatë se afati brenda të cilit u konstatua humbja e fuqisë së masës së sigurimit.

107.22 Subjekti e konsideron të drejtë konstatimin e Komisionit lidhur me mospërfundimin e hetimeve brenda afatit 6-mujor, për të cilin ka shpjeguar se kjo ka ardhur si rrjedhojë e mbingarkesës në punë, për shkak të mungesës së prokurorëve, por edhe të marrjes së dosjeve prej prokurorëve që nuk ushtronin funksionin.

107.23 Sa i përket konstatimit të Komisionit se nuk janë evidentuar veprime konkrete pas zgjatjes së afateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se dosja që i është vënë në dispozicion Komisionit, është dosja me provat vetëm për 5 të pandehurit që shërbejnë për provimin e akuzës ndaj këtyre shtetasve. Sipas subjektit, për procedimin fillestar është vendosur ndarja e tij dhe veprimet hetimore të procedimit të ndarë i cili është ende nën hetim, nuk janë pjesë e dosjes së vendosur në dispozicion të Komisionit. Arsyeja e mospërfshirjes së akteve të tjera ka pasur për qëllim ruajtjen e sekretit hetimor.

107.24 Në këtë kontekst, subjekti mendon se ndarja e çështjes nuk është bërë me qëllim favorizimin e asnjë personi, por ka ardhur si nevojë procedurale në momentin kur hetimet ishin të plota për personat që u morën të pandehur dhe nevojitej vazhdimi i hetimeve të tjera për persona që rezultonin gjatë hetimeve se kryenin veprimtari të paligjshme.

Vlerësimi i Komisionit

107.25 Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit mbi shkaqet që kanë shkaktuar vonesën e hetimeve lënë të nënkuptuar se subjekti nuk ka menaxhuar me efektivitet hetimin e çështjes, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të përfunduar hetimin, si dhe për të përballuar ngarkesën e punës. Në rastin konkret, keqadministrimi i çështjes duket se ka cenuar parashikimet ligjore të nenit 74, pikat 1, 2 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016, të cilat përfshijnë nënindiktorët matës për vlerësimin e aftësive organizative, si pjesë përbërëse e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

107.26 Sa i përket konstatimit të Komisionit për ndarjen e procedimit penal në mbarim të afatit hetimor, trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna dhe dosjes penale të administruar, çmon se vendimi për ndarjen e procedimit është i lidhur drejtpërdrejt me bindjen e brendshme dhe logjikën e subjektit të rivlerësimit, i cili, bazuar në vlerësimin e provave dhe ecurinë e hetimit, vendos se kur është momenti i duhur procedural për të kryer ndarjen e çështjes dhe vijimin e hetimeve. Pra, në këtë aspekt të aftësive të magistratit, Komisioni çmon se nuk mund të vlerësohet si matës i aftësive të profesionale të subjektit, në kuadër të këtij procesi. Arsyetimi i mësipërm gjen mbështetje në nenin 44, paragrafi 1 i ligjit nr. 84/2016, i cili referon kriteret e ligjit nr. 96/2016, si kriteret që duhen analizuar në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale të

subjekteve, ligj i cili në nenin 73, pika 4, ndalon vlerësuesin të çmojë aftësitë duke gjykuar korrektësinë dhe themelin e çështjes e duke zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

107.27 Përfundimisht, Komisioni ka konkluduar se është kompetencë e organit ILD për verifikim dhe vlerësim të mëtejshëm të kësaj çështjeje, nëse rezultojnë shkaqe dhe arsye për procedim disiplinor.

iv. Çështja penale nr. * me të pandehur R.M**

107.28 Denoncuesi pretendon se për këtë të pandehur prokurori Olger Eminaj ka pranuar kërkesën për zëvendësim mase pa asnjë kriter ligjor dhe pa asnjë ndryshim të rrethanave ku vetë e arrestoi dhe nuk bëri as ankim në Gjykatën e Apelit. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka dërguar dosjen përkatëse penale nr. ***, duke informuar se kjo çështje është në gjykim.

107.29 Nga verifikimi i kryer është evidentuar se subjekti ka shprehur miratimin e tij për zëvendësimin e masës së sigurimit nga “arrest me burg” në “arrest shtëpie” ndaj të pandehurit.

107.30 Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime mbi arsyet që çuan në miratimin e zëvendësimit të masës së sigurimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

107.31 Subjekti, përmes prapësimeve të datës 24.3.2023, ka shpjeguar se kjo çështje penale i është caktuar atij në tetor të vitit 2021, pasi më parë ishin ngarkuar me hetimin dy prokurorë të tjerë. Subjekti ka shpjeguar se që prej momentit që është ngarkuar me hetimin e kësaj çështjeje ka kryer një sërë veprimesh hetimore, duke kërkuar lejimin e përgjimeve, zgjatjen e afatit të përgjimeve ekzistuese, vleftësime sekuestrosh dhe kontrollesh etj. Si pasojë e këtij hetimi janë arrestuar në zbatim të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë gjithsej 7 persona, një prej të cilëve është edhe shtetasi R.M, ndaj të cilit është vendosur masa e sigurimit personal “arrest në burg”.

107.32 Në vijim, subjekti ka shpjeguar se ky shtetas në qershor të vitit 2022 ka kërkuar në gjykatë zëvendësimin e masës së sigurimit, duke parashtruar arsye shëndetësore të bashkëjetueses së tij, e cila ishte 7 muaj shtatzënë dhe kishte edhe një fëmijë të mitur. Subjekti ka shpjeguar se i pandehuri ka paraqitur në gjykatë prova se bashkëjetuesja e tij shtatzënë pak kohë para bërjes së kërkesës për zëvendësimin e masës, kishte qenë e shtruar në spital për arsye të rënda shëndetësore. Në këto kushte, nisur nga rrethanat familjare të të dyshuarit, është gjykuar se zëvendësimi i masës së sigurimit për këtë shtetas ishte një vendimmarrje e drejtë, për më tepër që masa e sigurimit personal të kërkuar nga prokuroria si pasojë e zëvendësimit kishte të bënte përsëri me kufizime të lirisë.

Vlerësimi i Komisionit

107.33 Pas shpjegimeve të subjektit, në referim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, të cilat përcaktojnë kushtet e kriteret e caktimit të masave të sigurimit dhe të ndryshimit të këtyre masave, si dhe vendimit të gjykatës, e cila ka ndryshuar masën e sigurimit personal nga “arrest me burg” në një masë më të butë “arrest në shtëpi” për shtetasin nën hetim, Komisioni argumenton se qëndrimi i subjektit lidhur me zëvendësimin e masës çmohet i drejtë, për sa kohë ky qëndrim nuk bie ndesh me ndonjë nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

v. **Çështja penale nr. *** me të pandehur F.I**, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Kjo çështje penale është ende nën hetim.

107.34 Nga verifikimi i kryer ka rezultuar se edhe për këtë shtetas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin e datës 19.2.2023, ka konstatuar se janë tejkuluar afatet e paraburgimit, pa u dorëzuar aktet në gjykatë, dhe në përfundim ka vendosur konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 24.2.2023.

107.35 Duket se subjekti nuk i ka përfunduar hetimet brenda afatit 8-mujor⁸⁶, duke shkaktuar humbjen e fuqisë së paraburgimit.

107.36 Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime mbi arsyet që kanë shkaktuar vonesën e hetimit dhe, për rrjedhojë, humbjen e fuqisë së paraburgimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

107.37 Subjekti, përmes prapësimeve të depozituara në datën 24.3.2023, ka shpjeguar rrethanat e çështjes penale të referuar nga policia gjyqësore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, e cila kishte informacion se një shtetas do të transportonte sasi lënde narkotike nga qyteti i Elbasanit në drejtim të Korçës. Pasi policia ka ndaluar mjetin në drejtim të shtetasit F.I, u konstatua një sasi prej 8 kg bimë e dyshuar *cannabis sativa*, si dhe rreth 500 g lëndë e dyshuar si narkotike, derivat i bimës narkotike *cannabis sativa*, për të cilën shtetasi F.I pretendonte se e kishte gjetur në rrugë dhe do e dorëzonte në polici.

107.38 Sa i përket konstatimit të Komisionit për mospërfundimin në kohë të hetimeve, subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se hetimet për rastin konkret paraqiteshin komplekse, kjo në kuadër të identifikimit të bashkëpunëtorëve të tjerë të mundshëm të këtij shtetasi dhe qëndrimit jobashkëpunues të tij. Subjekti ka shpjeguar se, ndodhur përballë situatës që hetimet nuk kishin mbaruar dhe po kalonin afatet e paraburgimit, ka kërkuar shtyrjen e afatit në gjykatë për 3 muaj, për të cilën gjykata ka vendosur të zgjasë afatin vetëm për 2 muaj. Subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se edhe pas zgjatjes së afateve të paraburgimit me vendim gjyqësor, nuk ka mundur të përfundojë hetimet dhe të ngejë akuzën. Ndodhur para nenit 264/2 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet zgjatja e afateve të paraburgimit vetëm një herë dhe jo më shumë se 3 muaj, për këtë shtetas u konstatua humbja e fuqisë së paraburgimit.

Vlerësimi i Komisionit

107.39 Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm arsyet që kanë shkaktuar tejkalimin e afateve hetimore dhe, për rrjedhojë, humbjen e fuqisë së paraburgimit. Nisur nga fakti që kjo çështje rezulton ende nën hetim, në zbatim të pengesës ligjore të parashikuar në pikën 2, neni E i Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues çmon të dërgojë këtë çështje për verifikim dhe vlerësim të mëtejshëm pranë organit kompetent të ILD-së.

⁸⁶ 6 muaj sipas parashikimeve të nenit 263/1/b dhe 2 muaj sipas vendimit të gjykatës, datë 18.12.2022.

vi. Çështja penale nr. *, me të pandehur D.B, U.S, A.F, R.S dhe K.Sh,** të akuzuar për kryerjen e veprës penale “ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal, si dhe ndaj shtetasit D.B akuzua për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

107.40 Bazuar në kërkesën e të pandehurve, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin datë 23.12.2021, ka konstatuar humbjen e fuqisë së paraburgimit për shkak të kalimit të afatit, pa u dorëzuar aktet në gjykatë, si dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” për të pandehurit.

107.41 Duket se subjekti nuk ka përfunduar hetimet brenda afatit 9-mujor⁸⁷, duke shkaktuar humbjen e fuqisë së paraburgimit.

107.42 Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, mbi arsyet që kanë shkaktuar vonesën e hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

107.43 Subjekti përmes prapësimeve të depozituara në datën 24.3.2023 ka shpjeguar, ndër të tjera, se hetimi për këtë procedim penal është kryer me metoda proaktive dhe si rezultat janë arrestuar në flagrancë shtetasit D.B, U.S, A.F, R.S dhe K.Sh. Subjekti ka shpjeguar se rrethanat faktike, që më pas çuan në arrestimin në flagrancë, kryesisht kanë pasur të bëjnë me vëzhgimin e fshehtë në ambientet publike, të kombinuar me përgjimet telefonike të personave të dyshuar, kryesisht shtetasin D.B.

107.44 Sipas subjektit, katër të dyshuarit kanë qenë duke udhëtuar me një mjet në aksin rrugor Korçë-Bilisht dhe, më pas, në drejtim të qytetit të Pogradecit. Duke pasur dyshime se shtetasit klandestinë ndodheshin pikërisht në këtë mjet, ai është ndjekur nga punonjësit e policisë gjyqësore. Gjatë ndjekjes, drejtuesi i mjetit është futur në rrugë dytësore, ku braktisi mjetin dhe është larguar. Në mjet u konstatuan 25 shtetas klandestinë me kombësi nga vendet e Lindjes. Më tej, subjekti ka shpjeguar se gjatë këqyrjes së mjetit furgon u gjet në cilësinë e provës materiale, ndër të tjera, edhe një bidon plastik uji, ku pas përpunimit me pluhur gjurmëzbulues u përftua një gjurmë papilare e vlefshme për identifikim.

107.45 Sipas subjektit, me qëllim zbulimin e drejtuesit të mjetit, bashkëpunëtorëve të tjerë të të arrestuarve, si dhe duke pasur dyshime se në këtë ngjarje kishte të implikuar edhe punonjës policie, janë kryer veprimet e nevojshme hetimore. Në krye të afatit 6-mujor, afati maksimal i paraburgimit për të arrestuarit, nga ana e subjektit si prokuror i ngarkuar me hetimin e çështjes është bërë kërkesë në gjykatë për zgjatjen e afatit të paraburgimit për 4 prej të dyshuarve, ndërsa për shtetasin K.Sh është bërë kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”.

107.46 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka pranuar kërkesën për zgjatjen e afatit të paraburgimit për 4 të dyshuarit, gjithashtu ka zëvendësuar masën e sigurimit për shtetasin K.Sh. Edhe pas kalimit të afatit 3-mujor të lejuar nga Gjykata, nisur nga kompleksiteti i çështjes nuk është bërë i mundur të përfundohet hetimi dhe të pandehurve t’u komunikohet akuzat. Po ashtu, subjekti ka shpjeguar se është gjendur në kushtet e pamundësisë procedurale për të kërkuar zgjatje të afatit të paraburgimit, bazuar në nenin 264/2 të Kodit të Procedurës Penale. Pas ngritjes së akuzës, të

⁸⁷ 6 muaj sipas parashikimeve të nenit 263/1/b dhe 3 muaj sipas vendimit të gjykatës, datë 17.9.2021.

pandehurit u deklaruan fajtorë dhe Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm për shtetasin R.S ka aplikuar dënim alternativ, vendosjen në periudhë prove.

Vlerësimi i Komisionit

107.47 Në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe dosjes penale të administruar, trupi gjykues vlerëson se pavarësisht se subjekti ka renditur shkaqet e vonësës së hetimeve, duke e cilësuar këtë procedim si një çështje komplekse, në kushtet ku Komisioni është para ndalimit ligjor të vlerësimit për themelin e çështjes, çmoi që shkallën e përgjegjësisë së subjektit në raport me rrethanat e çështjes mund ta vlerësojë organi kompetent ILD, duke konkluduar kështu për dërgimin e kësaj çështjeje për verifikim dhe vlerësim të mëtejshëm pranë këtij institucioni.

108. Verifikime të tjera

108.1 Komisioni ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë lidhur me çështje penale të hetuara nga prokurori Olger Eminaj për periudhën e ushtrimit të detyrës së tij si prokuror në vitet 2010 – 2022, të cilat kanë të njëjtën tipologji, “humbjen e fuqisë së paraburgimit”, të deklaruar me vendim gjyqësor.

108.2 Nga informacioni i ardhur prej Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë⁸⁸ kanë rezultuar, përveç çështjeve të trajtuara më sipër, edhe dy çështje të tjera penale me këtë tipologji, si vijon:

vii. Çështja penale me të pandehur M.K, i akuzuar për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

108.3 Edhe për këtë çështje penale, bazuar në kërkesën e të pandehurit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, përmes vendimit gjyqësor datë 22.4.2022, ka vendosur humbjen e fuqisë së paraburgimit dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, për shkak të kalimit të afatit 12-mujor nga fillimi i zbatimit të paraburgimit, pa i dorëzuar aktet në gjykatë.

108.4 Nga hetimi i Komisionit duket se subjekti nuk ka përfunduar hetimet brenda afatit 12- mujor dhe nuk ka paraqitur kërkesë për zgjatje të afatit të paraburgimit, duke shkaktuar humbjen e fuqisë së paraburgimit, në vështrim të nenit 263/1/c të Kodit të Procedurës Penale.

108.5 Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuar shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 mbi arsyet që kanë shkaktuar vonësën e hetimit, e cila ka passjellë humbjen e fuqisë së paraburgimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

108.6 Përmes prapësimeve të paraqitura në datën 24.3.2023, subjekti ka shpjeguar se ky procedim penal është regjistruar pas referimit të bërë nga policia gjyqësore lidhur me dyshimet e ngritura ndaj shtetasit M.K se kryente aktivitet të paligjshëm në fushën e shitjes së narkotikëve. Mbi këtë dyshim është autorizuar përgjimi i fshehtë i këtij shtetasi në ambiente publike, si dhe i personave të tjerë që do të kontaktonin me të, ku rezultoi se shtetasi F. K., vëllai i shtetasit M.K, është kapur nga policia gjyqësore dhe të cilit i janë gjetur tri doza të dyshuara lëndë narkotike me peshë të përgjithshme 1.2 g.

⁸⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 9.3.2023 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 20.3.2023 (e dërguar me *email*, datë 20.3.2023).

108.7 Subjekti e konsideron të drejtë konstatimin e Komisionit lidhur me vonesën e hetimit, e cila ka sjellë si pasojë humbjen e fuqisë së paraburgimit, duke shpjeguar se për hetimin e kësaj çështjeje ka qenë i ngarkuar oficeri i policisë gjyqësore I. H. (pranë Komisarariatit të Policisë Korçë), i cili është larguar më pas. Ndodhur në këtë situatë, hetimi i është ngarkuar një oficeri tjetër, B. C., panë Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë tek sektori i narkotikëve. Ky shtetas pak muaj më pas është transferuar brenda së njëjtës drejtori në sektorin e krimit ekonomik, por vazhdoi me hetimin e çështjes. Këto rrethana, si dhe ngarkesa në punë për periudhën në fjalë, kanë sjellë kalimin e afatit 1-vjeçar dhe, si pasojë, humbjen e fuqisë së paraburgimit. Subjekti ka shpjeguar se ky procedim penal është në hetim e sipër dhe se së shpejti çështja do të shkojë në gjykatë me akuzën përkatëse.

Vlerësimi i Komisionit

108.8 Komisioni argumenton se vonesat e veprimeve hetimore, që kanë çuar në humbjen e fuqisë së paraburgimit, mund të lidhen me rrethana, fakte apo prova të ndryshme, të cilat nuk mund të vlerësohen nga Komisioni, pasi çështja është ende nën hetim dhe në këto rrethana Komisioni gjendet në kushtet e pengesës ligjore për vlerësimin e subjektit, sipas parashikimit të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

viii. Çështja penale nr. * me të pandehur A.M,** i akuzuar për veprën penale “marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura”, në tentativë, parashikuar nga nenet 102/1 dhe 22 të Kodit Penal dhe “ngacmim seksual”, parashikuar nga neni 108/a/2 i Kodit Penal.

108.9 Për këtë çështje penale, prokurori Olger Eminaj ka kërkuar në gjykatë zgjatjen e afatit të paraburgimit për një periudhë 3-mujore, kërkesë e cila është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr. *** prot., datë 28.2.2020, me konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit për shkak të kalimit të afatit, si dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” ndaj këtij shtetasi.

108.10 Nga hetimi i Komisionit duket se subjekti nuk ka kryer në kohë veprimet hetimore, të cilat kanë sjellë për rrjedhojë humbjen e fuqisë së paraburgimit ndaj shtetasit nën hetim.

108.11 Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, mbi arsyet që kanë shkaktuar vonesën e hetimit, e cila ka passjellë humbjen e fuqisë së paraburgimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

108.12 Lidhur me konstatimin e Komisionit, subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se shtetasi A.M është arrestuar pas dyshimeve të arsyeshme për kryerje të marrëdhënieve seksuale me dhunë me të rritura dhe një ndër provat e kërkuara nga ana e Prokurorisë ka qenë edhe administrimi i aktekspertimit të ADN-së, kjo me qëllim kryerjen e një hetimi shterues. Duke qenë se gjatë periudhës 6-mujore nuk u bë i mundur administrimi i aktekspertimit të ADN-së, në këto kushte duke e vlerësuar si një provë të rëndësishme është kërkuar nga ana e tij si prokuror zgjatja e afatit të paraburgimit.

108.13 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë nuk e ka pranuar këtë kërkesë të prokurorisë, duke konstatuar humbjen e fuqisë së paraburgimit, si dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”. Subjekti ka shpjeguar se, pas administrimit të aktekspertimit të ADN-së, si dhe akteve të tjera hetimore, janë përfunduar hetimet dhe është ngritur akuza ndaj këtij shtetasi për veprat penale

“marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura”, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 102/1-22 i Kodit Penal dhe “ngacmim seksual”, kryer më shumë se një herë, parashikuar nga neni 108/a/2 i Kodit Penal. Kërkesa e Prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjykim është pranuar sipas akuzave të ngritura.

108.14 Subjekti ka argumentuar se, duke vlerësuar se Kodi i Procedurës Penale parashikon afate të ndryshme dhe të shkëputura për hetimin dhe gjykimin e një çështjeje (afate të ndryshme në hetim dhe afate të ndryshme në gjykim), gjatë gjykimit në themel të çështjes në fjalë, nga ana e tij si prokuror është bërë kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit personal për shtetasin A.M, duke vlerësuar se në momentin që çështja është në gjykim, fillojnë afate të reja paraburgimi. Me vendimin nr. ***, datë 2.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, është pranuar kërkesa e prokurorit për zëvendësimin e masës së sigurimit nga “arrest në shtëpi” në “arrest me burg” dhe shtetasi është arrestuar pas daljes nga salla e gjyqit dhe u dënua për akuzat e ngritura.

Vlerësimi i Komisionit

108.15 Komisioni vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti në prapësime, duke i konsideruar ato bindëse, nisur nga fakti se një nga arsyet kryesore të vonesës së hetimeve ka qenë marrja e një prove (akt ekspertimit të ADN-së), e cila për subjektin gjykohet e rëndësishme në ecurinë e hetimit. Për rrjedhojë, në këtë rast nuk janë konstatuar shkelje të subjektit.

Rivlerësimi i aftësive profesionale sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

109. Për të kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i është referuar:

i) Nenit E të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon rastet e prezumuara për marrjen e masave ndëshkuese për subjektet e rivlerësimit. Sipas kësaj dispozite ligjore, në procesin e vlerësimit tërësor të të gjithë komponentëve të vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, Komisioni konstatoi se nuk ndodhemi përpara ndonjë prej parashikimeve ligjore të kësaj dispozite, pasi nuk u vërtetua që subjekti: (a) ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të cekëta ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij (pika 3); (b) ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij dhe mangësia e vërejtur nuk mund të korrigjohet përmes programit njëvjeçar të edukimit (pika 4); (c) kryen veprime për të penguar ose vështirësuar vlerësimin e tij ose rezulton se ka njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime ose një model pune aq të dobët, saqë rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve (pika 5).

110. Bazuar në të gjitha sa janë evidentuar gjatë procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Olger Eminaj, Komisioni krijoi bindjen se problematikat e evidentuara dhe të trajtuara hollësisht në këtë vendim nuk mund të shërbejnë si shkaqe që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit E të Aneksit të Kushtetutës apo që ta bëjnë të papërshtatshëm në drejtim të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016.

111. Për më tepër, në zbatim të pikës 1 të nenit 42 dhe të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, duhet të jetë produkt i vlerësimit tërësor të burimeve të përcaktuara në ligj.

112. Në rrethanat konstatuese të evidentimit të mangësive për 3 çështjet penale, trupi gjykues vlerëson se në zbatim të nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, çështjet e mëposhtme duhet të transferohen pranë organit kompetent për inspektim, nëse verifikohen shkaqe që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, lidhur me:

- a) procedimin penal nr. ***, me të pandehur Xh.R, E.L dhe M.G për veprën penale “ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal;
- b) procedimi penal nr. ***, i regjistruar ndaj shtetasit nën hetim F.I për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal;
- c) procedimi penal nr. *** me të pandehur U.S, D.B, A.F, R.S dhe K.Sh, të akuzuar për veprën penale “ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal, si dhe ndaj shtetasit D.B akuza për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

ii) Referuar kritereve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, referuar të cilave Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit:

- a) ka treguar aftësi të mira profesionale, sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016;
- b) ka treguar aftësi të mira organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016;
- c) ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016;
- ç) ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Konkluzion mbi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

113. Për sa më sipër, sipas germës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar i aftë profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoji subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Olger Eminaj ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.
- b. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Olger Eminaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.
2. Transferimin e çështjeve penale të regjistruara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, që u përkasin procedimeve penale nr. ***/2020, nr. ***/2022 dhe nr. 179/2021, pranë institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore ose shkaqe për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik sipas pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 31.3.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Alma FASKAJ
Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha